



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2019, ora 12:45

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi në parim i të ardhurave të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2020

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Ervin Bushati, Arben Elezi, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Ylli Shehu, Eljo Hysko

Mungojnë:

Edlira Hyseni, Anastas Angjeli, Suzana Topi

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

1. Ministria Anila Denaj,
2. Zv/Ministri Elton Haxhi,
3. Z. Nikolla Lera, Drejtor I Pergjithshem I Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit,
4. Z. Endrit Lami, Drejtor I Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Sot në komision kemi diskutimin në parim të të ardhurave të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2020. Të ftuar në komision janë ministrja Anila Denaj, zëvendësministri Elton Haxhi, zoti Nikolla Lera, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makro-ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe të Punësimit dhe zotin Endrit Lami, Drejtor i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

Do të procedojmë në këtë mënyrë, në fillim ministrja do të na bëjë një paraqitje dhe më pas do fillojmë me diskutime, pyetje, qëndrime dhe opinione, nëse do të ketë nga të dyja anët e tryezës, qoftë nga opozita apo pozita.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Anila Denaj – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Programimi i të ardhurave për vitin 2020 mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidim fiskal, reduktim të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal nëpërmjet implementimit edhe të projektit të fiskalizimit, minimizimit të informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë edhe rritjen ekonomike të qëndrueshme nëpërmjet nxitjes së prodhimit dhe eksporteve. Në programin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për vitin 2020 janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshi efektin e rritjes ekonomike dhe indeksin e çmimeve, politikat e reja fiskale, si dhe efektet nga lufta kundër informalitetit e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjet e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Metodologjia e programit të të ardhurave është bazuar në modelet e njohura tashmë të programimit, si dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Cilat janë këto modele bazë? Parashikimet makroekonomike në lidhje me rritjen nominale dhe reale, modeli i bazuar në analizën e 60 grupprodukteve kryesore për mallrat e importit, modeli i bazuar në analizën e serive kohore, modeli i bazuar në koeficientin e elasticitetit. Në planifikim

janë harmonizuar faktorët makro-ekonomikë me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksat specifike.

Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhura janë: rritja nominale e produktit të brendshëm bruto, duke e analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorët e tjerë për çdo taksë në veçanti të ndërlidhura edhe me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare; kursi i pritshëm i këmbimit për dy monedhat kryesore dollarit dhe euros me lekun; çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe renta minerale; sasi të pritshme të importit të mallrave; rritja e të ardhura nga akciza për karburantet, cigaret, pijet e të tjera, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre në përputhje edhe me konsumin; rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në import, ajo brenda vendit; programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve me qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me 67% krahasuar me fundin e vitit 2019; rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimin e realizuar të operatorëve ekonomikë.

Më konkretisht, të ardhurat tatimore që mblihen nga administrata tatimore dhe ajo doganore në vitin 2020 programohen të jenë 334,12 miliardë lekë, me një rritje prej 6,42% ose 20,16 miliardë lekë më shumë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore parashikohen të jenë 103 miliardë lekë ose 4,7 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2019. Sqaroj se rritja e kontributeve është parashikuar duke ruajtur të njëjtin nivel të pagës minimale.

Të ardhurat doganore janë parashikuar duke u bazuar në analizën e trendit historik të 60 grupprodukteve për një periudhë 4-vjeçare. Ky parashikim është korrigjuar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm për secilën taksë. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë për bazë modelin statistikor të projeksionit të të ardhurave, si dhe faktorët ekzogjenë me ndikim në çdo taksë. Faktorët e jashtëm të marrë në konsideratë, të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2020 janë, së pari, kuadri makro-ekonomik; rritja nominale e prodhimit të brendshëm bruto e skontuar me koeficientin e elasticitetit është aplikuar duke e analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë, për çdo taksë në veçanti të ndërlidhura me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Efektet e politikave fiskale.

Për vitin 2020 nuk janë parashikuar ndryshime themelore fiskale, megjithatë prioritet do të jetë zbatimi dhe matja e efekteve të politikës fiskale të miratuara 2-3 vjetët e fundit me qëllim

konsolidimin e sistemit tatimor. Është e rëndësishme të theksojmë se duhet të konsolidojmë qëndrueshmërinë në politikat fiskale, duke stimuluar thjeshtësinë, transparencën, reduktimin e kostove të përmbushjes dhe mënjanimin e përjashtimeve apo tarifave favorizuese. Ndryshimi kryesor ka të bëjë me ligjin e fiskalizimit, i cili pritet të ndikojë në transparencën dhe kontrollin e transaksioneve tregtare nga koha që gjenerohen detyrimet tatimore.

Të ardhurat nga TVSH-ja parashikohen të jenë 151,6 miliardë lekë, 11,4 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2019. TVSH-ja do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve nga rritja e volumit të importeve dhe i konjunkturave të çmimeve ndërkombëtare, nga përmirësimi i administrimit, lufta kundër informalitetit dhe kontrollit zinxhir të transaksioneve nëpërmjet operatorëve.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin rritet me +8% ose 2,8 miliardë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2019. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet: në rritjen ekonomike të projektuar, në rritjen e vetëdeklarimit nga ana e tatimpaguesve, në forcimin e kontrollit të deklaratave bazuar në kriteret e riskut.

Të ardhurat nga akciza programohen 50,5 miliardë lekë me rritje 2,8 miliardë lekë më shumë ose 5,9% më shumë se i pritshmi 2019. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë rritje janë programi i rritjes së planifikuar të akcizës për cigaret me efekt 0,75 miliardë lekë, rritja me 4% e importit të prodhimit të karburanteve dhe të produkteve të tjera si birra, vera e të tjera; rritja e të ardhurave nga akciza e duhanit dhe zëvendësuesve të tjerë; lufta kundër informalitetit; kontrolli rigoroz i subjekteve të akcizës, si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohet 47,5 miliardë lekë, kjo në të njëjtin nivel me të pritshmin 2019. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat janë marrë në konsideratë: ulja e të ardhurave nga tatimi mbi dividendin, pasi në vitin 2019 u arkëtua përveç dividendit të vitit 2018 edhe devidenti i viteve të kaluara. Pra, ky faktor për rreth 6 miliardë lekë është marrë në konsideratë si *one off revenue new* dhe është axhustuar për vitin korrekt, rritja e numrit të të punësuarve bazuar në ecurinë e vitit 2019 dhe rritja e të ardhurave të tjera personale.

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera vlerësohen të jenë 39,5 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2020 janë 3,1 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2019. Të ardhurat nga taksat doganore në vitin 2020 vlerësohen të jenë 7 miliardë lekë me rritje 396

milione lekë ose 6% më shumë krahasuar me të pritshmin 2019. Në programin e të ardhurave janë marrë në konsideratë edhe efektet e rritjes së importeve të tatueshme.

Të ardhurat nga kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në vitin 2020 parashikohen të rriten me 4,8% ose 4,7 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019. Të ardhurat nga kontributet parashikohen të jenë 103 miliardë lekë nga 98,3 miliardë lekë që parashikohet të arkëtohen në fund të vitit 2019.

Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë: rritja ekonomike, çka do të reflektohet në rritjen e numrit të punëmarrësve, forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës së deklaruar dhe deviacionit së saj nga paga reale që përfitohet dhe ritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet 2 vjetët e fundit.

Zoti kryetar, më lejoni t'ju theksoj që ne kemi bërë një kalkulim të efektit të një mase *one off*, të cilën e përmenda edhe dje, si një iniciativë e diskutuar në këtë komision për rivlerësimin e pasurisë. Nëse do të aplikohet një përqindje të 3%-i, efekti do të ishte 4 miliardë lekë, duke vlerësuar që numri i pasurive që do të mund të rivlerësoheshin do të ishte në nivelin e 35 mijë pronave. Jemi të hapur për të diskutuar edhe një vlerë tjetër të këtij treguesi kundrejt diskutimeve në këtë komision.

Më lejoni t'ju them se jemi konsultuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Parave, e cila edhe më parë kur është bërë ky vlerësim dhe kjo procedurë ka si obligim të njoftojë strukturat e MANIVAL-it për të qenë koherent me aplikimin e këtij procesi.

Mbetemi të hapur për të gjitha pyetjet që ju do të keni. Së bashku me mua janë edhe kolegët, të cilët do t'ju përgjigjemi për çdo detaj. Nëse ka ende pyetje që nuk kanë përgjigje nga mbledhjet e mëparshme jemi të gatshëm për t'ju përgjigjur.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Fillojmë me pyetjet për ministren.

A kanë pyetje përfaqësuesit e opozitës?

Artur Roshi – Të gjithë parashikimin e projektbuxhetit të vitit 2020 e keni bërë mbi një bazament optimist, mirëpo që të jesh optimist duhet të kesh një realitet ekonomik, i cili është ai i vitit që po lëmë pas 2019-a. Në këtë kontekst mund t'ju përmend disa parametra që janë negativë për këtë vit, për shembull, rënia e të ardhurave nga doganat, eksportet, sigurimet shoqërore e të tjera në një kohë që ju pretendoni që është ulur papunësia, aty ka një kontradiktë e të tjera me radhë po të futemi në detaje.

Me këta parametra që ka, buxheti faktik i vitit 2019 nuk na bën optimist ose na bën të dyshojmë për optimizmin tuaj në projektbuxhetin e vitit që vjen. A mund të na përmendni disa parametra më konkretë se ku bazoheni në parashikimet tuaja? Në gjykimin tim rritja ekonomike që ju parashikoni prej 4,1% është e ekzagjeruar dhe në një farë mënyre është një vendim i paravendosur politik për të mbajtur nën kontroll trendin rritës të parametrave ekonomikë dhe perceptimin e publikut, si dhe nuk është një realitet i vërtetë ekonomik ashtu sikundër pretendojnë të gjithë për të na dhënë një impakt në buxhetet tona familjare. Për ne më të rëndësishme janë të ardhurat për frymë në buxhetet familjare sesa parashikimi optimist, qoftë edhe për të ruajtur këta parametrat psikologjikë të publikut.

Faleminderit!

Anila Denaj – Më lejoni t’ju theksoj që në dy seancat e mëparshme kemi folur për dy elemente, atë të të ardhurave, ato të pritshmet të vitit 2019, si dhe të ato të parashikuara për 2020-n në raport me kontributet.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mbani qetësi, të dëgjojmë ministren!

Anila Demaj – Është e vërtetë që i pritshmi 2019 në realizimin e të ardhurave të tij nga parashikimi është një diferencë, të cilën e kemi analizuar në të gjithë komponentët e tij ditën e djeshme. Ndërkohë, në raport me kontributet nuk më rezulton që është i saktë konstatimi juaj. Megjithatë, shqetësimi që ju keni për rritjen optimiste të parashikuar nga Ministria e Financave prej 4,1% për vitin tjetër, edhe kjo u trajtua dje, është një parashikim, i cili ka element të detajuar dhe zoti Lami do t’i argumentojë të gjitha. Unë e kam argumentuar dje këtë fakt në fjalën time, por meqenëse është i nevojshëm një detajim më i gjerë po ia lë fjalën kolegut për t’u shprehur në detaje dhe që ju të jeni të qartë se ky nuk është thjesht një projeksion optimist, por mund të jetë një realitet i prekshëm në ekonominë tonë.

Faleminderit!

Endrit Lami – Sa i takon projeksionit të rritjes ekonomike për vitin 2020 prej 4,1% që kemi...

(Diskutime pa mikrofon)

E mora fjalën në vijim të fjalës së ministres.

Arben Ahmetaj – Pse fjala merret nga ministrja?

Zonja Ministre, ia dhatë fjalën zotit Endrit?

Endrit Lami – Pra, rritja prej 4,1% që ne projektojmë mua më duket optimiste, megjithatë ne gjykojmë që nuk është optimiste, por realiste. Ku e bazojmë ne këtë?

Së pari, është i njëjti trend me rritjen e viteve të fundit. Ju do të thoni si ka mundësi, pasi 2019 është më poshtë? Është e vërtetë që është më poshtë, por është pothuajse tërësisht për faktorë specifikë, të luhatshëm dhe *one off*, të njëkohshëm që janë: energjia elektrike, e cila krahasuar me vjet që ka qenë një vit super i mirë sa i takon këtij sektori, ndërsa këtë vit ka qenë e kundërta, ekstremi tjetër, duke dhënë një efekt goxha negativ prej rreth 1,2 pikë përqindje.

6-mujori i parë, i cili ka një rritje prej 2,4%, nëse do të ishte një efekt neutral i energjisë, do të ishte plus 1,2 pikë përqindje më tepër, pra do të ishte rreth 3,6% plus është edhe efekti tjetër, edhe ky është *one off*, i cili do të shuhet vitin që vjen, efekti i pezullimit të lojërave të fatit. Edhe pse në totalin e peshës së ekonomisë ky aktivitet nuk ka një peshë të madhe, por fakti që zerohet fare, jep një efekt prej rreth 0,5-0,6 pikë përqindje plus është edhe efekti i fazës ndërtuese finale të projektit TAP, i cili më pas do të bëhet operativ dhe do të gjenerojë tjetër vlerë të shtuar, por deri më tani ka kontribuar nëpërmjet ndërtimit të tij. Përfundimi i kësaj faze ka bërë që edhe ky projekt i madh specifik të japë efektet e tij.

Pra, të gjitha këto efekte vitin që vjen priten të shuhen pothuajse tërësisht, megjithatë këto janë supozime, por mund të ndodhë që energjia vitin që vjen të ketë përsëri probleme. Efekti i lojërave të fatit patjetër do të shuhet, pasi baza është e njëjtë dhe kjo dihet, po ashtu edhe efekti i TAP-it. Këto efekte do të jenë të shuara dhe nuk do të jetë më ky efekt negativ plus që duke marrë në konsideratë faktin që të gjithë fondamentet e tjera makro-ekonomike janë ose në të njëjtin nivel stabil ose me një farë përmirësimi, këtu do të përmend disa prej tyre siç është tregu i punës që është kryesori jo thjesht për efektin e mirëqenies siç e thatë edhe ju, por është kritike edhe për vijimësinë e rritjes ekonomike afatmesme dhe afatgjatë, sepse dihet që gjeneron konsum, kursime dhe investime, duke mbajtur gjallë zinxhirin e gjenerimit të rritjes ekonomike.

Një faktor tjetër është perceptimi i përgjithshëm i agjentëve ekonomikë, bizneseve dhe konsumatorëve. T'ju them të drejtën, sa u takon konsumatorëve, 3-mujorin e fundin kanë pasur një lloj kontraktimi ose përkeqësimi sa i takon perceptimit, por megjithatë për të gjithë 3-mujorët e parë të vitit, duke marrë edhe gjithë agjentët ekonomikë së bashku, duke përfshirë biznesin dhe vizitorët, ky indeks është në përmirësim për 3-mujorin e tretë dhe patjetër që është ndjeshëm mbi mesataren e tij afatgjatë. Ne mendojmë se ky është një fundament tjetër shumë i rëndësishëm që krijon një premisë shtesë për...

Arben Ahmetaj – Zoti Endrit, a ka dalë 3-mujori i tretë për besimin e aktorëve?

Endrit Lami – Po.

Arben Ahmetaj – I treti?

Endrit Lami – Po ka kohë që ka dalë i treti...

Arben Ahmetaj – Ka dalë i dytë dhe jo i treti.

Endrit Lami – Ka dalë i treti, sepse del 1 muaj pas, pra që në muajin tetor.

Arben Ahmetaj – A mund ta kemi, ju lutem!

Endrit Lami – Ju do ta keni patjetër...

Arben Ahmetaj – Unë kam vetëm të dytin, por meqë jemi duke diskutuar planifikimin dhe në bazë të planifikimit është edhe besimi, pavarësisht se është i pafaktorizuar duhet ta shohim dhe t'i referohemi edhe pyetjes. Ndërkohë, besoj se do ta gjej zoti Lera, apo jo?

Elvin, të lutem, na e gjej pak besimin e aktorëve, indeksin nga Banka e Shqipërisë, të tretin!

Faleminderit!

Endrit Lami – Pra, perceptimi i agregatit të agjentëve ekonomikë i matur nëpërmjet këtij indeksi është në përmirësim edhe mbi mesataren afatgjatë dhe kjo përbën një premisë shtesë. Po ashtu kemi edhe sektorin financiar, cili përveçse se është stabil, edhe ky është një fundament shumë i rëndësishëm për të krijuar atë shtratin e nevojshëm për vijimësinë e rritjes ekonomike në këto nivele, në të gjitha parametrat e tij të shëndetshmërisë, të kapitalizmit, likuiditetit dhe të fitimit.

Së fundi, ajo që ka qenë e rëndësishme për këtë sektor, ka qenë edhe fakti se ka pasur një rritje të qenësishme të kreditimit të sektorit privat me rreth 7% gjatë vitit dhe ky është një ushqim shtesë që mund ta nxisë rritjen ekonomike për vitin tjetër.

Ka edhe disa faktorë të tjerë, siç është pjesa fiskale, qëndrueshmëria dhe kredibiliteti që indukton në ekonomi, qëndrueshmëria e financave publike, si dhe fakti që vijon konsolidimi fiskal, e cila diçka shumë kritike edhe përtej atyre diskutimeve, po sikur të bëjmë një politikë me ekspansionioste? Është e sigurtë që kjo do të kishte efekt të kundërt.

Arben Ahmetaj – Nuk ishte kjo pyetja.

Zoti Lami, referojuni pyetjes së saktë, pasi kohën e kemi të limituar.

Endrit Lami – Kisha edhe një sqarim të vogël, pasi çështjet më të zgjeruara i keni të gjitha në relacion.

Sa i takon pyetjes që ju thoni, që buxheti është optimist, duke e krahasuar me projeksionet e bëra nga institucionet e tjera si FMN-ja, Komisioni Europian dhe Banka Botërore nuk qëndron shumë më lart, pasi këto e kanë te 4%-i. Për shembull, Komisioni Europian të fundit fare e ka te 3,7%, FMN-ja e ka te 4%, ajo që u publikua në muajin tetor, por nuk e dimë se si do ta rishohë tani se është gjatë misionit, Banka Botërore e ka rreth 3,8%...

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Ndjesë! Për ta përmbledhur, në rritjen ekonomike prej 4,1% është parashikuar se konsumi total do të rritet në terma 2.5% duke dhënë një kontribut prej 2,3 pikë përqindjeje në rritjen e PBB-së. Investimet totale me rritjen prej 4,3% do të japin një kontribut me 1 pikë përqindjeje dhe kërkesa e huaj neto me efekt 0,8 pikë përqindjeje. Këta janë tre elementet që kanë çuar te 4,1%.

Arben Ahmetaj – Ka edhe një koment, zoti Roshi, sa i përket rritjes ekonomike, e cila do të jetë në ato nivele. Në historikun e kalkulimit të rritjeve ekonomike në vazhdimësi ne kemi tejkaluar parashikimin e BB-së dhe FMN-së, apo edhe të BERZH-it. Në natyrën e tyre institucionet janë pa konservatorë edhe për frenuar qeveritë për t'u ekspansionuar indirekt në llogaritë fiskale. Pra, është një instrument jo thjesht statistikor, është edhe një instrument kontrollues. Po t'u referohemi 3 vjetëve të fundit, kur gjykojmë rritjen dhe kontributin e energjisë elektrike, në rritje ne marrim të gjitha fluktuimet 3-4 vjeçare, sepse Shqipëria e ka në natyrë të klimës së vet, ku indirekt pastaj është kontributi i energjisë elektrike në rritjen ekonomike. Fluktuimet janë të kontrolluara, 2 vjet janë të lagështa dhe 1 vit i thatë. Ne nuk e komandojmë dot klimën, por në logjikën që ndërtojnë qoftë INSTAT-i, qoftë bankat, qoftë Ministria e Financave, qoftë pastaj parashikuesit e tjerë e marrin parasysh këtë. Ka edhe një element tjetër që nuk e përmendi Endriti, dhe nuk e përmendi me qëllim, mundësia e 4,1%-shit do të vijë edhe për shkak të bazës së këtij viti, që nuk do të jetë aq sa është parashikimi, por do të jetë në debat profesional që bëjmë me njëri-tjetrin 2,7-3. Dikush tjetër mund të mendojë se do të jetë 3-3,5, por duke qenë se baza e këtij viti do të jetë më e ulët se parashikimi, kërcimi i vitit tjetër do të jetë më i mundshëm në 4,1%. Po ta shohësh te përlllogaritja e të ardhurave ne do të duhet të marrim të ardhurat, e viteve 2018, 2019, 2020, që të gjykojmë Ministrinë e Financave ose trajektoren e të ardhurave. Pse? Unë do të bëja llogari mesataren e viteve 2019-2020. Viti 2019 është vit specifik dhe ritmi i rritjes së të ardhurave 3,1% nuk është te 6,2%. Që ta gjykojmë ministrinë nuk mund të marrim vetëm një fashë të dhënash. Kur them të gjykojmë ministrinë,

them të gjykojmë trajektoren e të ardhurave. Te rritja ekonomike duhet të kemi parasysh këtë që unë ndava me ju. Është e kollajtë të bësh fajtor parashikuesin për 4,1 % ose për 2,3%, por praktikisht trajektorja duhet gjykuar jo në një fashë, por në disa fasha.

A ka pyetje tjetër?

Artur Roshi – Optimistit kur nuk i mbeten para në xhep, me të fundit para që ka, blen portofolin. Kështu që kam frikë se qeveria është në këtë situatë, sepse nuk ka investime në infrastrukturë qoftë atë rrugore, ose energjetike, por ka në reforma, për shembull, për faturat elektronike të trajtave bashkëkohore të teknologjisë. Unë do të thosha është mbështetje luksi, një reformë luks që nuk sjell impakt të menjëhershëm në ekonomi, është afatgjatë, është e tërthortë, përtej investimeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për reformën fiskale në tërësi, për faturat elektronike...

Pra, e vetmja nga ato që vlen, sipas meje gjithmonë, është mbështetja e reformën, në drejtësi, që mund të japë impakt në drejtësinë që kërkojnë bizneset, për shembull, në raport me pronat, investimet, me sigurinë tyre këtu, është e vetmja reformë që jep impakt.

Pyetja ime është: Pse ju jeni kaq optimistë? Duke e anashkaluar pothuaj tërësisht infrastrukturën, a ju duket ky një buxhet i tkurrur? Koncepti juaj është që buxheti i ardhshëm të ngrihet vetëm me shtimin e taksave?

Në mënyrë të tërthortë këtu me paketën fiskale që keni sjellë u shtoni telashet bizneseve, edhe nëse ju nuk u vendosni taksë taksative do ta merrni atë në mënyrë të tërthortë. Pra, ju krijoni një telash më shumë, për shembull, siç është deklarimi i individëve poshtë 20 milionëshit në vit, ose taksat e luksit, të regjistrimit që keni për makinat, për të mos u futur te paketa, se mund ta diskutojmë një herë tjetër. Pra, pse ju jeni fokusuar tek ato reforma dhe jo tek investimet e drejtpërdrejta në infrastrukturë? Po marrim, një shembull, që biznesi të jetë rentabël, nëse nuk bën investime në teknologjinë e tij, nëse është një linjë prodhimi, po themi ne, nuk mund të rrisë të ardhurat e tij. E njëjta gjë është edhe buxheti, nuk është ndonjë filozofi e madhe që ne mbetemi në detaje se pas detajeve mund të fshihet djalli, por jo qeveria.

Arben Ahmetaj – Po, Blerina.

Kur t'ju vijë radha.

Blerina Gjylameti – Bazuar në relacionin që na ka ardhur për rritjen e të ardhurave dhe ku do të bazohet ajo, një nga elementet që bie në sy është rritja e të ardhurave, që ka të bëjë

me përmirësimin e administrimit fiskal nëpërmjet implementimit të projektit të fiskalizimit, po ashtu luftës ndaj informalitetit, të cilat ndikojnë në rritjen ekonomike të qëndrueshme, si edhe në nxitjen e import-eksporteve.

Duke parë të dhënat që kemi dhe rritjen në zërat e ndryshëm së pari, thuhet që një nga elementet që do të ndikojë në rritjen e të ardhurave nga TVSH-ja ka të bëjë me pjesën e luftës ndaj informalitetit, përmirësimin e administrimit, kontrollit zinxhir e me radhë. Do të doja të dija se sa është vlera e pritshme e rritjes së TVSH-së nëpërmjet përmirësimit të administrimit.

Një vend të konsiderueshëm zë rritja e vetëdeklarimit nga ana e tatimpaguesve. Do të doja të dija se çfarë do të bëhet ndryshe në vitin 2020 për të përmirësuar më tej rritjen e të ardhurave nga vetëdeklarimi. Pra, cilat janë masat që parashikon administrata tatimore dhe ministria në politikat e saj për të përmirësuar vetëdeklarimin? E dua me një shifër konkrete. Sa pritjet të jetë parashikimi i rritjes së të ardhurave nga rritja e vetëdeklarimit të tatimpaguesve. Gjithashtu, të ardhurat nga kontributet shoqërore, sigurimeve shoqërore. Ne në realitetin shqiptar kemi një situatë të trashëguar në vite, ku vit pas viti në këto 6 vjet janë bërë ndryshime të konsiderueshme, por përsëri ndërmjet asaj që deklarohet dhe pagës reale ka një diferencë shumë të madhe dhe shmangia është e konsiderueshme. Këtë e kemi kuptuar edhe me atë çfarë ndodh rregullisht., pasi persona të caktuar kanë vështirë të deklarojnë të ardhurat e tyre për sa kohë punëdhënësi deklaron një pagë shumë më të ulët nga ajo që realisht iu jep nën dorë. Unë do të doja të dija se çfarë masash do të merren për ta ndryshuar këtë lloj realiteti. Sa është efekti i pritshëm edhe nga ky ndryshim?

Kam një çështje tjetër, rritja e pritshme nga të ardhurat nga akciza me 4 % të import prodhimit të të gjitha karburanteve dhe produkteve të tjera të akcizueshme, siç janë birra, vera e të tjera. Rregullisht në këtë komision, kur kemi pasur dëgjesa me sektorin e prodhimit të pijeve, është ngritur ky shqetësim, akciza që paguhet për prodhuesit vendas me akcizën që paguajnë ata që importojnë është në vlerat, të cilat janë disproporcionale dhe nuk mbështesin prodhimin vendas. Konkretisht, duke qenë se këtu është në një zë dhe thuhet rritja me 4%, flas për të gjitha ato, zoti Lera, meqenëse bëtë habi, këtu keni qenë edhe ju, bëhet fjalë për ata 200 hektolitrit që kemi diskutuar rregullisht. Çfarë keni menduar dhe si mendoni se do të rritet prodhimi vendas? Çfarë konkretisht do të bëjmë që të nxisim prodhimin vendas? Ky është viti i 7-të që unë jam deputete. Sa herë që ne diskutojmë buxhetin ose paketat fiskale, kemi dëgjesa me prodhuesit e

birrës, pra me të gjithë sektorin e prodhimit që ngrenë këtë lloj shqetësimi. Si e keni menduar këtë, sepse, qoftë për verën, qoftë për birrën, është i njëjti shqetësim.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj –Më lejoni, zoti kryetar t'i jap edhe një përgjigje zotit Roshi, pasi është shumë e nevojshme që kur të flasim dhe komentojmë jo vetëm për të ardhurat, ju folët shumë edhe për pjesën e shpenzimeve edhe pse sot fokusi janë të ardhurat, të mos keqinformojmë.

Është shumë e rëndësishme që, së pari, të mos anashkalojmë faktin që investimet në infrastrukturën rrugore ekzistojnë, janë procese të cilat sigurisht nuk janë ndërprerë, dhe obligimi i ministrisë përgjegjëse për këtë do të jetë kur të jetë vetë ministrja këtu për të mbrojtur projektet e saj.

Megjithatë, kjo nuk është e parëndësishme në këtë projektbuxhet, sikurse reforma në drejtësi, e cila në vitin 2020 merr përtej të gjithë buxhetit të këtij viti edhe 1,1 miliardë shtesë, përveç 300 milionëshit që është te fondi rezervë, apo shëndetësia dhe arsimi.

Të gjitha këto nuk janë të parëndësishme për t'u thënë tek të gjithë pjesa e shpenzimeve, megjithatë të mos keqinformojmë për taksat e reja nëpërmjet procesit të fiskalizimit, sepse nuk janë taksa të reja. Prandaj duhet të kemi një farë mase përgjegjshmërie kur japim disa komente të përgjithshme, sepse nuk janë të argumentuara.

Sa i përket informalitetit, është e vërtetë që të vendosësh një masë për të vlerësuar efektin e pritshëm mbi luftën e informalitetit duhet të kesh një fillesë mbi bazën e së cilës përlllogarit informalitetin, sektorët dhe të gjithë planin e masave për të shkuar te rezultati. Sa kohë që ne këtë projeksion e kemi mbështetur në përpjekjen e këtij viti për të luftuar informalitetin, me të gjitha format dhe mundësitë e bashkëpunimit, konstatimi ynë si në atë të informalitetit në biznes, ashtu edhe në raport me punësimin është se na ka bërë të ndërgjegjshëm që të marrim në analizë përpjekjen për të reduktuar sa më shumë të mundemi me masat tona të brendshme qoftë administrative, ose edhe ato fiskale dhe të shohim një përfshirje më të madhe edhe në të ardhurat e rritura vitin tjetër.

Arben Ahmetaj- Ministre, a mund të ndalemi pak këtu te logjika që ndatë me zonjën Gjylameti? Pra, ju thatë se informaliteti është diku 35-40%?

Anila Denaj- Unë nuk thashë që informaliteti është 35-40%, nuk ka mundësi të bëj referencë informaliteti, sepse nuk ka një bazë.

Arben Ahmetaj- Po 30-40 % çfarë është?

Anila Denaj- Është efektiviteti i inspektimeve tona, që do të thotë se nga të gjitha inspektimet që kemi bërë si në sektorë të caktuar që kemi evidentuar me risk, në raport me inspektimet nga tregu i punës, por edhe në inspektimet në biznes, për masat administrative të administratës tatimore ky është variabli i efektivitetit të inspektimeve. Nuk mund të jetë masë reference informaliteti, sepse nuk mund ta vlerësojmë, por ka qenë një bazë e mjaftueshme për të vlerësuar përpjekjet tona për të administruar më mirë edhe të ardhurat.

Arben Ahmetaj- Për ta lehtësuar pyetjen, zonja Gjylameti, mbase edhe për ta ndihmuar ministren që të na japë shifrën, mund të ishte në mënyrën e përlogaritjes 6,2. Sa për qind është efektiviteti i administratës? Pra, gjithmonë në përlogaritje dhe metodologji përmirësimi administrativ ose efienca e administratës ka një kuantifikim. Nëse mund të na e thoni atë kuantifikim, do të ishte më e thjeshtë për zonjën Gjylameti.

Anila Denaj - Nga masat fiskale të vitit 2020 ne kemi gjykuar që 4,75 miliardë janë efektet e politikave fiskale dhe 4,6miliardë janë efektet e përmirësimit të administrimit tatimor.

Sigurisht, do t'i shkojmë tani zë më zë edhe me kolegun zotin Lera. Por më lejoni të theksoj se në këtë përpjekje për administrimin më të mirë të masave antiinformalitet ne po diskutojmë së fundi, por ka shumë rëndësi gjithë procesi i riorganizimit të administratës tatimore dhe i ngritjes së sistemeve. Të dyja së bashku janë pjesë e politikës vitin tjetër, të cilat nuk janë të dukshme sot.

Për çështjet që kanë të bëjnë edhe me akcizën dhe tatim paguesit individë zë më zë do të flasë zoti Lera.

Arben Ahmetaj – Zoti Lera, para se të flisni për të ardhurat nga akciza, a mund të ndani me ne edhe në funksion të pyetjes si kanë ecur mallrat e akcizës këtë vit në krahasim me planin? Ju lutem, flisni me ngadalë që të mbajmë shënime ne si deputetë! Pra, po i referohem planit 10- mujor.

Nikolla Lera- Në vitin 2019 kemi realizuar një rritje të të ardhurave tatime, dogana, kontribute, 4,12 %. Bazuar në metodat standarde të programimit, kemi parashikuar rritjen në tatimet 6,42% për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë që në vitin 2019, krahasuar me vitin 2019, kemi realizuar një rritje 4,12%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

2,6 nga kjo që ju thashë, por edhe kontributet ne i konsiderojmë tatime, sepse administrohen dhe mblidhen si çdo tatim tjetër.

Arben Ahmetaj– Nuk janë tatime, mbliidhen si tatimet e tjera, por nuk janë tatime, janë investime të qytetarëve për të ardhmen. Janë të ardhura në buxhet, por nuk janë tatime.

Nikolla Lera- Janë të ardhura në buxhet, për të cilat përdoren të njëjtat metoda administrimi si për çdo tatim tjetër.

Arben Ahmetaj - Po është konsekuencë e punësimit.

Nikolla Lera- Ky planifikim është bërë duke përcaktuar në mënyrë të saktë bazën e vitit 2020. E kemi zhveshur nga çdo faktor që nuk do të ketë impakt në vitin 2020 dhe kemi bërë edhe ndarjen e planit sipas zërave. Tani, për të kaluar në pyetjen e zonjës Gjylameti për zërat e veçantë, kemi rritur tatimin mbi vlerën e shtuar 8,1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019. Pse? Sepse impaktin kryesor rritja ekonomike dhe deflatori e jep te tatimi i vlerës së shtuar. Ai është tatimi që direkt impaktohet nga rritja ekonomike më e ulët ose më e lartë, sepse ndikon direkt te çmimet e shitjes së mallrave, por njëkohësisht ne kemi arritur tatimin mbi vlerën e shtuar mbi rritjen normale ekonomike që kemi projektuar, sepse tatimi mbi vlerën e shtuar është tatimi kur ne duhet të luftojmë informalitetin, ku ne duhet të përmirësojmë mekanizmat e kontrollit. Fiskalizimi si reformë do të synojë...

Arben Ahmetaj – Zoti Lera, ju thatë që po rrisni 8,1%, që i bie gati 11 miliardë. Të gjitha ato që thatë pse nuk vlejné për vitin 2019, por vlejné për vitin 2020?

Nikolla Lera- Për vitin 2019 ne kemi ecur mbi të njëjtën logjikë planifikimi, mbi të njëjtat parametra, por ne shpjeguam këtu dhe në mënyrë analitike efektet që kanë dhënë kursi i këmbimit, rritja ekonomike jo në nivelin optimist të planifikuar, ndryshimet ligjore, pas miratimit të buxhetit dhe një sërë faktorësh të tjerë që jua kemi sjellë dhe me shkrim.

Jemi treguar të kujdesshëm në projeksionin qoftë të kursit të këmbimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Të jemi pak më të qartë me njëri-tjetrin. Deri tani ju thatë se do të keni një rritje të pritshme 8,1% nga TVSH-ja. Pyetja ime ishte çfarë ka ndryshuar nga viti 2019 që ne do të realizojmë këtë rritje ekonomike me 8,1%. Pra, për sa kohë në rritjen e të ardhurave fokusi kryesor ishte dhënë përmirësimi i administrimit fiskal nëpërmjet implementimit të projektit të fiskalizimit, lufta ndaj informalitetit, nxitja e import-eksportit e me radhë. Pyetja ime është: çfarë ka ndryshuar nga viti 2019? Deri tani më shpjeguat ekzaktësisht atë çfarë është bërë në vitin 2019, po të njëjtat gjëra po thoni edhe për vitin 2020. Dua të di ndryshimin, sepse të themi që do të kemi përmirësim me 8.1% duke përmirësuar administrimin

fiskal, duke nxitur 1, 2, 3 gjëra që përmenda, që të mos kaloj në përsëritje, dua të di çfarë do të ndryshojmë ekzaktësisht, që të dimë se kjo që kemi parashikuar do të realizohet.

Në relacionin me zëra konkretë për TVSH-në kemi vendosur tri elemente, pra TVSH-ja pritet të rritet:

1. Nëpërmjet gjenerimit të rezultatit të rritjes ekonomike. Sa është rritja e pritshme nga kjo?

2. Nga rritja e volumit të import-eksporteve. Sa është kjo rritje? 3?

3. Nga përmirësimi i administrimit (që ishte pyetja ime).

Po kështu, edhe në çdo zë tjetër, qoftë nga akciza, qoftë në pjesën e kontributit të sigurimeve shoqërore.

Për pjesën e miradministrimit ka shumë rëndësi të dimë se për sa kohë ne jemi një ekonomi, e cila ka një informalitet të caktuar, pavarësisht luftës që është bërë ndër vite, çfarë do të bëjmë ndryshe sivjet që ta ndryshojmë këtë realitet?

Kjo është pyetja ime, ju mund vazhdoni të më jepni përgjigje çfarë të doni.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Lera, fjala për ju.

Nikolla Lera – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Unë isha pikërisht në përgjigje të pyetjes suaj.

Në total ne do të rrisim të ardhurat për vitin 2020 me 6.4% dhe këtë shifër e kemi argumentuar që do të vijë nga rritja ekonomike. Për këtë ju kemi vënë në dispozicion tabela të detajuara, rreth 25 miliardë nga faktorët e rritjes nominale dhe 9.4 miliardë nga politikat e reja fiskale dhe miradministrimi. Nga këto 9.4 miliardë, ministrja shpjegoi se 4.75 do të jetë efekti i politikave, 4.6 në tatime plus kontribute dhe rreth 6 miliardë nga miradministrimi.

Ne e kemi zbërthyer këtë efekt nga miradministrimi bazuar në metodat standarde të programimit sipas tatimeve dhe taksave, por impakti nuk mund të jetë i njëjtë në çdo tatim, sepse miradministrimi apo impakti ekonomik afekton më shumë tatimin mbi vlerën e shtuar, jo akcizat që janë me kuotë fikse dhe as taksat nacionale.

Lidhur me tabelën analitike që po kërkon, kemi dhjetëra tabela në Excel që nuk i kemi sjellë këtu, por mund t'juja vëmë në dispozicion kurdo që ta kërkon.

Çfarë rezulton nga këto? Nga rritja prej 6 miliardësh e miradministrimit që kemi parashikuar për vitin 2020, pjesa më e madhe do të jetë tek tatimi mbi vlerën e shtuar, sepse aty e

kemi problematikën, nuk e kemi tek taksat nacionale, por te tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi korporativ, që lidhet me kontrollin e bizneseve dhe tek akciza, që ka të bëjë me procedurat doganore.

Arben Ahmetaj – Zoti Lera, pa vazhduar më tej, 8.1% është TVSH-ja bruto, apo neto?

(Diskutim pa mikrofon)

Është TVSH-ja bruto.

Po rimbursimi sa planifikohet?

Të bëj një pyetje më të thjeshtë edhe për kolegët? Keni parashikuar 151 e 621 miliardë TVSH, apo jo? Kjo është bruto apo neto?

(Diskutim pa mikrofon)

Është bruto.

(Diskutim pa mikrofon)

Kjo është neto, Niko. Të pyeta për bruto.

(Diskutim pa mikrofon)

Në përqindje?

(Diskutim pa mikrofon)

Na jep bruto, që të ndaj me kolegët edhe trendin e rimbursimeve, sepse, në qoftë se i referohemi vitit 2019, TVSH-ja bruto ngeli e njëjtë me një vit më parë dhe **pejsi** i rimbursimeve u rrit, ndërkohë, që siç e the edhe vetë, ankora kryesore ku reflektohet rritja apo edhe informaliteti është TVSH-ja bruto, jo neto. Meraku im është që të mos na ndodhë si në vitin 2019, që, në qoftë se nuk e kapim, ngadalësojmë rimbursimet dhe prekim edhe investimet, sepse pardje iu referova investimeve publike më të ulëta se viti 2019 dhe buxhetit fillestar të vitit 2019 të investimeve. Ai merak për ne, si maxhorancë, është shumë i rëndësishëm, ndaj do të lutesha të na orientosh edhe në këtë drejtim.

Faleminderit!

Nikolla Lera – Tatimi mbi vlerën e shtuar bruto, bazuar në projeksionin e rimbursimeve që do të jepen, do të jetë 172 miliardë lekë. Ne kemi projektuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rritja shkon nga 160 në 172, pra 12 miliardë lekë.

I bie 8 %. Kemi adresuar përfundimisht problemin e rimbursimit në mënyrë që Ministria e Financave të mos akuzohet më për mosdhënie të rimbursimeve. Në fund të vitit 2019,

adresojmë plotësisht çdo tatimpagues të vogël, e kemi adresuar që tani, nuk do të kemi më vonesa, ngelet vetëm stoku i një tatimpaguesi me të cilin kemi **installment** për t'i paguar...

Arben Ahmetaj – Që ta kuptojnë qytetarët: kemi marrëveshje afatgjatë, që është instrument tradicional në çdo drejtori të përgjithshme të Europës.

Pra, për masa të mëdha që vijnë për shkak të investimeve të mëdha, menjëherë ka gradualitet. 8% është rritje e konsiderueshme, të dashur kolegë. Ministria e Financave ka vendosur një rritje të konsiderueshme duke besuar te rritja ekonomike, aftësia e administrimit dhe përmirësimi i instrumenteve, duke iu referuar edhe fiskalizimit. Orientoje në këtë drejtim diskutimin, Niko.

Nikolla Lera – Duhet patjetër që në projeksionet e TVSH-së të vendosim variantet më optimiste, sepse ato do të vënë në punë administratat dhe do t'i detyrojnë ato të përmirësojnë performancat e tyre në kontrollin e TVSH-së.

Arben Ahmetaj – Nuk besoj se keni vendosur variant optimist!

Nikolla Lera – Nuk është variant pesimist, nuk është as mesatar, është variant optimist nisur edhe nga ajo që thatë se çfarë u realizua në vitin 2019.

Arben Ahmetaj – Niko, nuk është variant optimist, sepse ministrja me të drejtë dhe në korrektesë të shifrave, iu referua rritjes ekonomike, përmirësimit të administratës, instrumenteve teknologjike, pritjes së investimeve të huaja, kështu që 8% mos e quaj “optimist”, sepse pastaj i bie që të na japësh mundësinë të hyjmë taksë më taksë.

Pra, mos iu refero si optimist, është korrekte me të gjitha parashikimet ekonomike, por jo optimiste. I referohet rritjes së investimeve, asaj që pëlqej unë kur bëj debat me ju ndonjëherë, është formimi i kapitalit fiks bruto që do të rritet, punësimin për të rritur, investimet e brendshme për të rritur, turizmin gjithashtu sepse të gjitha kanë si trajektore këto 6 vitet e fundit.

Pra, nuk është optimist, se ndryshe i vemi shifrave të tjera dhe i quajmë pak pesimiste.

Mbarojeni fjalën, Niko.

Nikolla Lera – Duhet t'i jap përgjigje zonjës Gjylameti.

Lidhur me akcizat, për mallrat kryesorë jemi në parametrat e projektuar për vitin 2019, pra kemi një rritje. Karburantet dhe cigaret përbëjnë pjesën dërrmuese të mallrave të akcizës. Te cigaret, në fund të vitit, do të jemi në nivelin 3100 tonë, me një përmirësim mbi 150 tonë, krahasuar me vitin e kaluar dhe për vitin 2020 planifikojmë të njëjtin ritëm rritjeje që të ecim gradualisht me akcizat.

Ndërsa me karburantet kemi qenë në ritmin e rritjes 3-4% në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 dhe do të ruajmë të njëjtin ritëm rritjeje.

Lidhur me pijet që përmendi zonja Gjylameti, birrën, verën, do të ndalem te birra, ne kemi një akcizë të diferencuar në bazë të sasisë së prodhimit që të stimulojmë prodhuesit vendas në mënyrë indirekte, sepse iu marrim akcizë më të reduktuar, ndërkohë që për verën pjesa dërrmuese e importuesve paguajnë akcizën me nivel të lartë, për birrat mund të mos jetë e njëjta situatë...

Arben Ahmetaj – Më falni! Pse pjesa dërrmuese, zoti Lera? Cili nga operatorët paguan nën 200 mijë hektolitër? Asnjë nga operatorët nuk duhet të paguajë nën 200 mijë hektolitër. Për vitin 2018 patëm vendosur akcizë të barabartë me importin. Nuk duhet të ketë operatorë importues përveç këtyre vendas, që të paguajnë nën 200. Pra, duhet të paguajnë akcizë të barabartë me të gjithë të tjerët.

Nikolla Lera – Nuk ka! E kisha fjalën për verën, sepse të gjithë importuesit e birrës paguajnë akcizë me nivel të lartë, ndërsa prodhuesit vendas paguajnë akcizë me nivelin e ulët.

Arben Ahmetaj – Kaq! Kjo është e rëndësishme për komisionin dhe qytetarët, që politika që ndjek qeveria është në favor të mbështetjes së prodhuesve vendas. E para.

E dyta, instrumentet ndër vite kanë marrë të gjithë operatorët importues dhe i kanë çuar për shkak të kontrollit dhe administrimit te niveli i lartë i akcizës. Qytetarët kanë nevojë ta dëgjojnë këtë gjë.

Nikolla Lera – Kjo është e saktë!

Por e kisha më tepër tek importuesit e verës, sepse identifikimi i prodhuesve të verës është më i vështirë. Ka qindra e mijëra importues vere dhe është i vështirë identifikimi i sasive të prodhimit dhe verifikimi i deklaratave që bëjnë importuesit vendas.

Lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore... (*mungesë audio*) 4.9 -5%. Pse e kemi parashikuar këtë ritëm? Sepse edhe ritmi i rritjes në vitet 2017-2018 ka qenë diku te 7%, por në vitin 2019 një pjesë të efektit rreth 0.9% e jep rritja e pagës minimale, ne e rritëm nga 24 në 26 %. Nuk kemi projekt për rritjen e pagës minimale në vitin 2020, pra e gjithë kjo rritje prej rreth 5% do të jetë nga miradministrimi dhe nga impakti i rritjes ekonomike.

Pra, ne nuk mund të vazhdojmë të rrisim kontributet me 10%, siç i rrisim në vitet 2015-2016, sepse edhe shkalla e informalitetit është reduktuar. Unë e shpjegova, dje kishim 450

mijë të punësuar në listëpagesë, sot kemi 700 mijë, por ne nuk mund të parashikojmë të kemi 1 milion, sepse dihet numri i të punësuarve sa mund të jetë.

Arben Ahmetaj – Më falni, por unë kam dëgjuar edhe Kryeministrin, edhe ministren t'i referohen instrumentit të rritjes së pagës mesatare dhe deklarimit, që do të thotë që rritja e të ardhurave nga kontributi i sigurimeve duhet të ndjekë logjikën e modelit dhe nuk mund të dalë jashtë saj, aq më tepër që ti e bazon modelin mbi të gjitha tek rritja ekonomike, qoftë tek importi i aksueshëm, qoftë të bazës së taksueshme të brendshme dhe, për rrjedhojë të rritjes së punësimit me instrumentin e miradministrit rritet paga mesatare dhe deklarimi, sepse e kemi diskutuar disa herë që duhet të reflektohet në buxhet, megjithatë, ky është një diskutim që do të bëhet kur të vijmë nën për nen.

Do të lutesha, që në referencë të pyetjes, të bënit edhe një parashikim statistikor aq sa ç'ju lejojnë statistikat. Pra, numri i vendeve të punës në jobujqësor, sepse kryesorja vjen nga bujqësori, i cili është një **miniscule** gati i papërfillshëm, dhe e dyta, paga. Do të ishte shumë me rëndësi për ne, që edhe ta argumentojmë me njëri-tjetrin, por edhe do të na duhet t dimë se si të ecim në këtë trajektore.

Nikolla Lera – Keni të drejtë lidhur me kontributet...

Arben Ahmetaj – Niko, do më falësh një sekondë të komunikoj pak me kolegët e mi?

Nuk do të ikim nga komisioni pa bërë të gjitha pyetjet, qoftë opozita, qoftë pozita dhe pa marrë përgjigjet. Niko, do të flasë i fundit, ai do ta mbyllë mbledhjen.

Fjala për ju, Niko.

Nikolla Lera – Është e vërtetë që për kontributet, fokusimi duhet të jetë te niveli i pagës. Do t'ju japim statistikat, sepse kemi rritje të nivelit të pagës mesatare nga viti në vit.

Arben Ahmetaj – O Niko, ke nja 3 ditë që thua do t'i japim, do t'i japim!

Pres mallrat, nuk më kanë ardhur; pres TVSH-në bruto zyrtarisht, nuk më ka ardhur; pagat nuk më kanë ardhur! Të lutem, nëse ke kohë sot, a mund të mi sjellësh nesër?

Nikolla Lera – Të gjithë informacionin e kemi me vete, por nuk u krijua mundësia t'ju japim.

Lidhur me përmirësimin e pagës mesatare, kemi rritje, natyrisht, por kemi edhe mjaft probleme. Nuk gjykoj se mund dhe duhet të rikthehemi përsëri te paga reference, por duhet të rrisim patjetër mekanizmat e kontrollit dhe të menaxhimit të riskut në mënyrë që të verifikojmë rastet më sinjifikative të nënvlerësimit të pagave ose të deklarimit të tyre joreale dhe jo të sakta.

Natyrish, kjo është një luftë e vazhdueshme që administrata tatimore e bën çdo ditë dhe do të vazhdojë ta bëjë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Niko!

Lidhur me tabelën e mallrave të akcizueshme që kam këtu, më keni dhënë planin, a keni ndonjë fakt të tetëmujaorit?

Nikolla Lera – Nuk e vendosëm këtu, sepse po presim që të dalë i plotë edhe dhjetëmujaori, në mënyrë që ta kemi jo nëntëmujaor, që logjika të jetë më e saktë në analizë.

Arben Ahmetaj – Në respekt të punës që ke bërë një jetë, a ka mundësi që të mos i shmangesh gjësë, më sill dhjetëmujaorin, se e kanë kërkuar deputetët. Gjykimin na e lër neve. Në qoftë se nuk ke besim te gjykimi ynë, do të na korrigjosh, patjetër. Ti na sill shifrën që të kërkojmë. Nëse do të ngecim në logjikën për dymujaorin, do të të pyesim.

A mund të na sjellësh dhjetëmujaorin?

Nikolla Lera – Këtë po shpjegoja, kryetar.

Kam nëntëmujaorin të përgatitur....

Arben Ahmetaj – Në eksperiencën time modeste në Ministrinë e Financave që nga '92, operativja del në datën 3. Unë këtë kërkoj, se nuk do të shtrëngoj ty pse nuk më solle evidencën për datën 11 të muajit pasardhës, por më sill operativen.

Fjala për zonjën Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Do të doja t'i kthehesha edhe një herë luftës kundër informalitetit. Kam dy pyetje që lidhen me këtë. Një pjesë të përgjigjes së pyetjes së parë, e mora, por gjithsesi do ta riformuloj edhe njëherë, që në qoftë se ministrja ka diçka për ta thënë, le ta thotë, në qoftë se mendon se e ka ezauruar pyetjen, jam shumë dakord.

Në relacion, por edhe gjatë fjalës suaj thatë se në parashikimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë disa faktorë dhe midis tyre ishte edhe lufta kundër informalitetit. Pyetja ime është: a keni parashikuar mekanizma shtesë për vitin 2020 në luftën kundër informalitetit, apo do të vazhdojë po kjo luftë aksioni e kontrolli nëpër biznese?

Pyetja e dytë, që përsëri ka lidhje me informalitetin, ka të bëjë me një sektor të veçantë siç janë lojërat e fatit. Vitin e kaluar morëm një vendim shumë të rëndësishëm për mbylljen e të gjitha bizneseve që operojnë në fushën e lojërave të fatit. Ishte një vendim i rëndësishëm dhe ne

jemi të ndërgjegjshëm për impaktin që kishte ky vendim në grumbullimin e të ardhurave, por, të gjithë ramë dakord që efekti social është shumë më i madh dhe prevalon mbi efektin që do të kishte në buxhetin e këtij viti. Çfarë ka ndodhur? Gjatë këtij viti ka pasur dyshime dhe është folur herë pas here, njerëzit lexonin edhe nëpër medie, se ka pasur raste që funksionojnë në mënyrë të paligjshme, në ilegalitet. Do të doja të dija çfarë masash ka marrë ministria për ta monitoruar situatën, për ta kontrolluar nëse është e vërtetë apo jo, a keni konstatuar raste, apo jo. Cilat janë mekanizmat që po përdorni për ta frenuar këtë fenomen, nëse ekzistojnë? a keni mundësi t'i kontrolloni lojërat *online*? Kjo është pyetja.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Në të ardhmen do të vijmë për diskutim edhe instrumentet për të realizuar qoftë edhe në masën 4.5-4.6 miliardë lekë.

Më lejoni të them se ne kemi depozituar pranë zyrës së Kryeministrit edhe një platformë të të gjitha projeksioneve tona të masave për vitin që vjen në raport me luftën ndaj informalitetit, i cili në thelb synon një plan masash si në aspektin strukturor ku administrata tatimore doganore është duke analizuar në kontekst strukture sesi mund të përmirësohet që të jetë e eficientë dhe më pas përkrah saj të vijmë në ndihmë dhe suport trajnime të përshtatshme për të lexuar mirë të dhënat dhe për të qenë në inspektimet tona.

Unë kam thënë edhe më parë se inspektimet nuk janë *ad hoc*, por janë në bazë të një matrice risku. Këto të fundit nuk janë të harmonizuara, por po punojmë të harmonizojmë edhe matricat e riskut në kontekstin e elementeve dhe jo në kontekstin e emrave të bizneseve, sepse ajo është pjesë e procedurës. Mbi të gjitha ne duam që biznesi të vizitohet sa më pak nga inspektorët, por monitorimi në distancë dhe ai mbi bazë të të dhënave të jetë ai më i përdoruri dhe të kemi mundësi të bëjmë vizita frekvente aty ku evazioni apo informaliteti është më i lartë.

Në këtë aspekt struktura do të ketë ndryshime për vitin që vjen, sikurse edhe një plan masash që besoj se do të kemi edhe mbështetjen e ndërkombëtarëve për ta vijuar.

Shumë i rendësishëm në diskutimin tuaj është edhe elementi i lojërave të fatit, administrimi i pjesës që është brenda njësisë së menaxhimit të lojërave të fatit ka të bëjë me monitorimin e lojërave *online* dhe në këtë aspekt më lejoni të them se jemi ende duke përfunduar procesin e riorganizimit të strukturave për të qenë më eficientë. Përpjekja për të

luftuar informalitetin që ekziston jo në kontekstin fiskal, por në atë të mashtrimit për këtë veprimtari besoj se nuk i takon vetëm Ministrisë së Financave si objekt veprimtarie, por është e të gjithë strukturave. Besoj se të gjithë janë të vëmendshëm që kudo ku janë në përplasje me këtë fenomen, ta luftojnë atë. Megjithatë, po, ekziston dhe ne jemi të gjithë të vëmendshëm që ta luftojmë, por nuk e materializojmë dot në shifra konkrete.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zonja Ministre!

Ka pyetje tjetër?

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam disa pyetje. E para, në projektbuxhetin e vitit 2020 është parashikuar që burimet e financimit për institucionet e vetëqeverisjes vendore do të rriten me 5,7 miliardë lekë ose 11,2% më shumë sesa realizimi i pritshëm i vitit 2019.

Pyetja ime është: cilat mendoni se do të jetë burimet kryesore që do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave në institucionet e vetëqeverisjes vendore?

E dyta, nga momenti i miratimit të aktit normativ “Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2019” ato nuk u bënë. Si paraqitet realizimi i treguesve të buxhetit, kryesisht të ardhurave për vitin 2019?

Kam një pyetje tjetër, në vijim të asaj që e përmendi zoti Niko, për vitin 2019. Ju keni parashikuar të mbledhni 6,1 miliardë lekë kontribute nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Ndërkohë që për vitin 2020 parashikoni një rritje afërsisht 4,8% të sigurimeve shoqërore ose 4,7 miliardë lekë më shumë se viti 2019. Si parashikoni që të realizohet ky plan për vitin 2020, ndërkohë që rritja e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore ka ardhur edhe për faktin që e tha zoti Niko se është rritur paga minimale nga 24 mijë në 26 mijë lekë, kur në fakt nuk do të kemi rritje të pagave. Si do ta mbuloni këtë diferencë?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre!

Anila Denaj - Pushteti vendor, në fakt edhe këtë vit ka qenë në raport me pritshmëritë, e kemi diskutuar dhe e kemi aprovuar edhe në aktin normativ që rritja edhe këtë vit ka qenë e konsiderueshme dhe kjo tendencë do të vazhdojë edhe vitin tjetër. Bazë në pushtetin vendor janë taksat lokale dhe ajo e pasurisë.

Më lejoni të them se pushteti vendor nuk e ka përdorur të gjithë hapësirën që mund të ketë për të marrë një burim të madh të ardhurash. Kadastra fiskale që është një projekt jo pak i rëndësishëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është një proces në gjysmë të rrugës edhe për faktin e mungesës aktive të të gjithë përfaqësuesve të pushtetit vendor, 33 nga bashkitë ende nuk kanë marrë vendimet në këshillat bashkiake në raport me këtë projektligj. Është një mënyrë e mirë për ta ftuar pushtetin lokal që të marrë vendime, sipas ligjit që është në funksionim.

Një mënyrë shumë e mirë e përdorimit të të gjithë hapësirës fiskale që ka pushteti lokal, ezauron jo vetëm 11,7%, por edhe më shumë, sikurse edhe transferta e pakushtëzuar që sigurisht në nivelin 1% u shpërndahet bashkive.

Për sa i takon pjesës së të ardhurave, të cilat vijnë nga kontributi i sigurimeve, personalisht mendoj se ne kemi një hapësirë shumë të madhe ende të papërdorur nga informaliteti gri.

Kjo hapësirë mund të ezaurohet edhe përtej mosrritjes në nivelin e të njëjtit rritëm në vitet e mëparshme. Më këtë nuk dua të them se përpjekja për të luftuar informalitetin nuk ka qenë më parë, por mënyra e përqendruar dhe inspektimet e shpeshta që janë bërë, sidomos në bizneset me një numër të konsiderueshëm punonjësish, duke e faktorizuar këtë si një element risku, përveç të tjerave, mendoj se mund të ndikojë në mënyrë më të qenësishme vitin tjetër për të rritur këtë burim të ardhurash.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, në korrektesë të arsyetimit arsyeja pse e thirra zotin Niko ishte që të verifikoja një shifër, të cilën e kam nga doganat, sasia në tonë e cigareve, importit po i referohem, për 10-mujorin është 2468 tonë, që do të thotë se ka një mesatare 10-mujore prej 240-250, për periudhën që ka ikur, kam një arsyetim pse po e them, që do të thotë se për të kapur 3100, duhen gati 632 tonë në 2 muaj. Kjo do të thotë të paktën 300 tonë në muaj, që është një kërcim mbi 10%.

Po pyes zëvendësministrin, me dakordësinë tuaj: si kanë qenë muajt nëntor-dhjetor të viteve të tjera për të parë kërcimin mujor të krahasuar dhe për të thënë: “Po, do të arrijmë 3100”, që iu referuat, sepse është shumë e rëndësishme për të konsoliduar të pritshmin.

Edhe ministrja në Konferencën e Kryetarëve iu referua zyrtarisht të pritshmit. Pyetja ime e natyrshme është që ky i pritshëm do të na bëhet fakt? Ky është merakun im. Ky i pritshmi që kemi shënuar këtu së bashku, do të na bëhet fakt? Pasi mbi këtë kemi planifikuar apo jo?

Të njëjtën gjë mund të bëja edhe për karburantin, edhe për pijet alkoolike në tërësi, por për cigaret e kemi si sondim.

Niko Lera – Për projeksionet, ju e dini se kemi mbi 2 muaj që kemi filluar, që në shtator. Edhe për projeksionet për mallrat e akcizës, kemi marrë në konsideratë faktin e asaj periudhe dhe parashikimin e organeve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për arkëtimet e pritshme të 4 muajve. Nga ajo analizë...

Arben Ahmetaj - Të lutem, të kthehem te pyetja ime, në ndihmë të njëri-tjetrit! Qëllimi i pyetjes sime është të konsolidojmë të pritshmin. Është shumë e rëndësishme që ta konsolidojmë të pritshmin. Mos harroni se do ta kalojmë në parim më 5 dhjetor dhe në 19 dhjetor do ta kalojmë nën për nën, që do të thotë se gjithë ky *puzzle* që kemi në një moment të caktuar në operativen e nëntorit, është mbyllur. Duke marrë parasysh që ligji i ndalon importuesit e cigareve që të kalojnë mbi 15% të normativës mujore, pasi ka ndryshuar ose është lajmëruar ndryshimi i politikës si në rastin konkret rritja e akcizë dhe merakut im është: a do t'i kapim dot 315 tonë? Nuk dua të merrem me decimale, por me konsolidimin e të pritshmit, sepse nëse konsolidojmë të pritshmin mirë, e dimë se vitin tjetër është e konsoliduar si e ardhur. Më thoni vetëm kaq: merrni 4 muaj të vitit 2018, 2019 për të parë nëse do të kemi mundësi, sepse të dyja kanë pasur ndryshim të politikave, kanë të njëjtin profil muajsh në politika dhe në sasi. Pra, 4 muaj me 4 muaj për të parë, nëse do të arrijmë dot ta kapim atë importim të cigareve.

Mos u merr tani me këtë gjë që të devijojmë nga themeli i gjësë. Të lutem, nëse mundesh brenda ditës së sotme deri në darkë na e dërgoni nëpërmjet sekretarisë së komisionit që thjesht kur të kthemi në shqyrtimin nën për nën ta dimë nëse e kapim apo jo. Kjo ishte arsyeja pse të pyeta: është planifikim apo jo, duke iu referuar faktit të 10-mujorit?

Po, zoti Sinaj.

Më fal, është Ervini, e kërkoi më përpara fjalën, por edhe se ka munguar, pasi ka qenë i deleguar në Strasburg, që atje më dërgonte *e-mail*-e për disa shqetësime dhe pyetje. Prandaj dua që ai t'i bëjë ato sot që ka mundësi.

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati - Isha në Berlin.

Arben Ahmetaj - Unë kujtova se ishe në Strasburg. Më fal!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në radhë të parë me vjen mirë që dëgjoj ministren, e cila thotë se po përpiqen t'i ulin sa më shumë masat shtrënguese dhe të rrisim ato motivuese. Për një vend, aq më tepër që do të formalizojë ekonominë, që përpiket të promovojë paqe, nuk do të më pëlqente termi “lufta”. Me biznesin duhet të kemi të njëjtën përjasje. Të flasim për një mbështetje ndaj formalizimit dhe jo për luftë ndaj tij. Besoj më tepër në politikat motivuese dhe në këtë pikë ne kemi ndërmarrë një sërë nismash në këtë komision për të lehtësuar biznese apo sektorë të caktuar, si ulja e TVSH-së për turizmin, agrobiznesin, masa të tilla pozitive, me të cilat mendonim se do të formalizohet më shumë ekonomia dhe do të rriteshin të ardhurat. Tani, që ta dimë në të ardhmen, kur na vijnë këto propozime, pasi me të drejtë të gjithë kur vijnë llojnë për grupimet e tyre si industria e turizmit: si kanë qenë parashikimet dhe si ka ndodhur në realitet?

Këto masa pozitive që kemi marrë si janë përkthyer më vonë në të ardhura të rritura? Ne nisim shumë iniciativa të mira, pastaj *follow up*-i është ai që çalojmë. Me qëllim që edhe ne t'u kërkojmë nesër më shumë industrive, nëse kemi 1, 2, 3 dhe 4 masa pozitive.

E dyta, vlen në të gjithë botën që gati 10% apo 20% e bizneseve kryesore mbajnë peshën 80% të të ardhurave. Ka disa kanale të mëdha ku mund të kontrollohet që nga zinxhiri i TVSH-së nga firmat e mëdha kryesore që sjellin dhe importojnë në Shqipëri për të parë më poshtë se si shkon zinxhiri, sepse është një kokë. Duke kontrolluar këta apo duke ndërmarrë disa iniciativa pozitive me firmat kryesore, a mundet që ta kontrollojmë më mirë zinxhirin e të ardhurave në të ardhmen?

E treta, a mund të ndërmerren masa që të orientojnë ekonominë drejt pagesave *online*, sepse që aty mund të promovojmë më shumë firmat kryesore që të fusin në hullinë e të gjithë ekonomisë TVSH-në që kur vjen. Pastaj në nivelet kapilare do ta bënte të pamotivuar represionin. Kjo pjesë sa mund të avancojë? Ka vende që e kanë mbyllur derën e informalitetit, duke bërë pagesat *online*.

Anila Denaj- Ju falënderoj!

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, faktikisht do të ishte një mënyrë për të dhënë platformën sesi unë si ministre do të imagjinoja 2-3 vjetët e ardhshëm.

Të 3 elementet që ju përmendët janë të adresuar në qasjen tonë afatmesme. Së pari, në raport me analizën *cost-benefit* të të gjitha masave, të cilat janë marrë me një objektiv shumë të qartë për të stimuluar sektorë të ekonomisë. Ata sektorë të ekonomisë që janë stimuluar janë:

bujqësia dhe turizmi. Asnjëri nga ne nuk mund të thotë të kundërtën. Nëse masat kanë qenë të plotë, nëse efektiviteti i tyre ka qenë i plotë, nëse koha ka qenë e mjaftueshme, kjo është pjesë e një analize. Kjo analizë mund të bëhet në mënyrë të herëpashershme dhe jo vetëm në këto momente. Ne i kemi hyrë kësaj analize edhe me ndihmën e FMN-së, është një grup që po na ndihmon. Është një analizë që po e bëjmë së bashku me ta dhe besoj se në fillimin e vitit tjetër do të kemi një qasje më të qartë dhe cilësore edhe pse kemi diçka.

Si do të na ndihmonte kjo analizë? Jo vetëm për të parë efektivitetin, por mbi të gjitha për të parë edhe thjeshtimin e procedurave. Çfarë ndodh kur ka diferenca nga një vit në tjetrin? Udhëzimet që bëjmë ne, duke i bërë shpesh në janar-shkurt koha nuk është e mjaftueshme. Mundet që të mos shihen të gjitha aspektet rregullative dhe krijojnë hapësira, që mund të vendoset informaliteti apo udhëzimet të jenë jo aq të qarta sa që krijojnë kosto edhe në raport me klimën e biznesit. Pra, në të dyja aspektet edhe për kosto-analizë, por edhe për thjeshtim të procedurave ky proces ka nisur.

Për sa i përket zinxhirit të informacionit midis administratave tatimore dhe doganore duhet të intensifikohet, pasi nuk mund të pretendojmë të rrisim informacionin në një administratë dhe të mos ta kryqëzojmë atë me një administratë tjetër. Për këtë nuk ka nevojë për organizimin institucional, por për një mënyrë ndryshe të leximit të të dhënave në mënyrë më inteligjente, e cila sigurisht në përpjekjen për të rritur pjesën e marrjes së informacionit edhe brenda projekteve siç është ai i fiskalizimit, por jo vetëm, besoj se do të konkludojë në një projekt afatmesëm një vit një vit e gjysmë, të plotë. Nuk mundet që në të njëjtin moment të japim të gjitha masat. Në momentin që materializohen këto masa të përthithjes së informacionit, të vendosjes së informacioneve për t'u digjestionuar edhe nga biznesi të vazhdojmë më tej me reduktimin e ekonomisë nëpërmjet limitimit të shumave të qarkullimit kesh. Mendoj se kjo do të ishte për një periudhë të dytë, sa të konsolidojmë iniciativat e ndërmarra. Është një përpjekje e nisur edhe me Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, e cila po diskutohet, por jo për ta afektuar me një datë konkrete. Në të 3 kapilarët që përmendët ka një interes nga ana jonë, ka një diskutim, diku jemi më të avancuar, diku jemi në proces dhe tjetra është për projektion.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, në të njëjtën logjikë për konsolidimin e të pritshmit, dua që stafi të bëjë edhe një analizë për karburantin, sepse të njëjtin fenomen shikoj edhe te karburantet. Është i njëjti merak. Besoj se gjatë ditëve që do të vijmë duam një analizë më të freskuar duke iu referuar 10- mujorit dhe ecurisë për të qenë më punkltualë te shifrat.

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kam një pyetje të shkurtër sqaruese.

Sa për qind e pagesave kalojnë nëpërmjet pagesave *online* që dihen sipas shpenzimeve? Sa për qind e pagesave në total janë *online*? Shtetet maten me efikasitetin e tyre, sesa pagesat *online*, që janë të futura në sistem me karta, ose ma bankë. Sa për qind e tyre në Shqipëri bëhen *online* ose ma karta? Ia kam bërë pyetjen edhe Bankës së Shqipërisë dhe nuk ka ndonjë përgjigje të saktë.

Arben Ahmetaj - Çfarë i kërkon Ministrisë së Financave. Ministria e Financave e kontrollon atë?

Ervin Bushati - Meqenëse Banka e Shqipërisë nuk ka të ardhura për të mbledhur dhe nuk raporton për të ardhurat.

Arben Ahmetaj - Ervin, ti je përfaqësues i “*New Economy*”, *the economy of knowledge and technology*.

Nuk ke nevojë, se do t’ia kërkojmë Guvernatorit. Kur të vijë ai, zoti Bushati do t’i bëjë të njëjtën pyetje.

Ervin Bushati - Ka sot ekonomi shumë të përparuara, ne nuk jemi si ato. Niveli i pagesave *online* në Suedi që është më e larta është 96%. Vetëm 4% është kesh. E di që Shqipëria nuk është në këto nivele edhe anasjelltas, por të paktën të kemi një informacion që të fillojmë të vendosim disa targete gjatë rrugës.

Arben Ahmetaj - Zoti Bushati po në Itali sa është?

Ervin Bushati – As 40%.

Arben Ahmetaj – Kesh-i?

Ervin Bushati- Jo *online*. Po Italia nuk është rast i mirë.

Arben Ahmetaj - Po Franca?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vlerësoja që të bëni pyetje në lidhje me përgjegjësitë e ministres.

Ervin Bushati - Po, këtë po them. Sa paguhet këtu, që të dimë për pagesat *online*, sepse fillon dhe kontrollohet. Ta dimë për shembull, se kemi 20% dhe për 2 vjet do të shkojmë në 25, 30 apo 40%. Nëse nuk vendosëm disa targete do të vijmë gjithmonë dhe do të flasim me terma të strategjive afatmesme.

Arben Ahmetaj – Zonja ministre foli me shifra, me planifikim, me metodologji. Unë iu referova me të njëjtën gjë, vetëm ti fole me strategji.

Ervin Bushati - Ishte një pyetje e thjeshtë, pasi më intereson.

Anila Denaj- Kam dëshirë që kur t'i referohem një shifre, t'i referohem edhe një burimi. Këtë statistikë që kërkon, do ta marr pas fiskalizimit, pas *business to business* në vitin 2021 për të qenë të saktë. Kjo nuk do të na heqë aspak përgjegjësinë për të pranuar se kjo përqindje nuk është e lartë. Banka Qendrore mund t'i referohemi, ju vetë e thatë, se nuk e ka të saktë, sepse duhet të merret me të gjithë totalin e ekonomisë.

Në raport me disincentivimin e kesh-it në qasjen tuaj është një qasje e saktë pro. Nuk është e vetmja dhe në qasjen që po diskutojmë qoftë afatmesme, nuk e kemi vënë të parën, e kemi vënë të dytën. E para, sepse kemi embarguar në një proces përmirësimi të të dhënave dhe të informacionit më të gjerë dhe në një proces miradministrimi, qoftë edhe në strukturat e administratës, të cilën nuk e kam efektive, por e kam të projektuar për vitin tjetër. Nuk mundet që të gjitha masat të shkojnë në një ditë, sepse edhe për biznesin është e vështirë që t'i digjestionojë të gjitha, pasi nuk janë vetëm masa iniciativuese, në rastin konkret janë shtrënguese.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zonja Ministre!

Ka pyetje tjetër?

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj - Faleminderit!

Dëgjova raportimin që bëri zonja ministre për të ardhurat. Shikoj këtu te materiali që kemi përpara se të ardhurat kryesore janë të shënuara nga tatimet, doganat, nga TVSH-ja e ardhur nga doganat, TVSH-ja e brendshme, akciza, të ardhura të tjera nacionale, të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Kam një merak, sepse disa nga këto të ardhura mund të ndikojnë te rritja e të ardhurave bë buxhet.

Nga ana tjetër, ka edhe efekt, mendoj unë, negativ. Për shembull, të ardhurat nga TVSH-ja në dogana flasin për nivelin e lartë të importeve që kemi në ekonominë tonë.

Unë doja të dija për të ardhurat nga eksportet. Nuk dëgjova këtu ndonjë raport për këto të ardhura dhe si i llogarisim të ardhurat nga eksportet në vendin tonë. Mendoj se të ardhurat nga eksportet ndikojnë shumë në ekonominë e vendit dhe sidomos në rritjen e besimit të shqiptarëve

për të qëndruar këtu në Shqipëri, pra për rritjen e mirëqenies së shqiptarëve, për rritjen e numrit të punonjësve të punësuar në industrinë tonë.

Brenda kësaj pyetjeje për të ardhurat nga eksportet, doja edhe një informacion se si ka ndikuar ulja e TVSH-së në grumbullimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sepse në këtë rast ka të bëjë me eksportet. Për shembull, grumbullimi i perimeve nga fermerët shqiptarë dhe eksporti i tyre.

Si ka qenë eksporti i perimeve gjatë vitit 2019, pasi vitin e kaluar kemi miratuar në paketën fiskale këtë ndryshim dhe këtë shkallëzim të TVSH-së për këto produkte.

Më ra në sy edhe diçka tjetër. Ka një program të tërë qeveria shqiptare që është zhvillimi i qyteteve dhe investimet që janë bërë për rritjen e turizmit, rilindja urbane, dhe nuk pash ndonjë të dhënë se si janë llogaritur të dhënat nga turizmi. Çfarë efekti ka pasur turizmi në ekonominë shqiptare për këtë vit?

Gjithashtu, kur fola për eksportet, doja të dija edhe të ardhurat nga renta minerare. Si janë llogaritur këto për vitin që vjen?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Më lejoni t’ju kërkoj që ta saktësoni pyetjen!

Ju kërkuat të ardhurat nga eksporti. Nuk ka taksa eksporti Republika e Shqipërisë. Në qoftë se je duke folur për kontributin e eksporteve në rritjen ekonomike dhe kuantifikimin e tyre në llogaritë kombëtare, kjo është një gjë komplet tjetër.

Edhe kontributi i asaj që quhet “eksporti neto”, pra që quhet edhe eksporti i shërbimeve, ku hyn turizmi, sepse në buxhet të ardhurat nga zhvillimi ekonomik, ku indirekt është edhe eksporti, është indirekt dhe nuk mund t’i marrim një këtu dhe një atje të puthitura. A e keni fjalën për llogaritë kombëtare për rritjen ekonomike apo e keni për buxhetin e shtetit?

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Kemi fatin që ju vini nga Ministria e Financave dhe e njihni shumë mirë këtë fushë, duke na e lehtësuar punën në komision.

Arben Ahmetaj – Ky është qëllimi pse jam këtu.

Vullnet – Në lidhje me eksportin, doja të theksoja se nuk ka vetëm produkte të eksportit, të cilat nuk ndikojnë në buxhetin e shtetit, por ka edhe produkte të eksportit, siç janë nafta apo mineralet e ndryshme nga të cilat vijnë të ardhura nga akciza. Janë të ardhurat e rentës minerare, që është 10% dhe kjo hyn në buxhetin e shtetit direkt nga këto eksporte.

Edhe për turizmin doja ta dija mendimin në nivelin ekonomik, ngaqë është një program i madh i qeverisë “Rama”, rilindja urbane.

Arben Ahmetaj – Në nivelin ekonomik? Dakord.

Pra, jemi duke folur për rentën minerare dhe për kontributin e sektorëve që kanë eksport të konsiderueshëm.

Anila Denaj – Unë do t’ia kaloj zotit Harxhi përgjigjet për gjithë pjesën e rentës minerare, por më lejon të theksoj një element të rëndësishëm në vijim të diskutimit se farë efekti ka pasur ndryshimi i TVSH-së së ndryshuar në rimbursimi, që ju e ngritët si pyetje që ditën e parë dhe që nuk ka marrë përgjigje.

Në fakt, në paketën fiskale të vitit të kaluar, edhe në fillim të këtij viti ne jemi përballur me shumë pyetje, shqetësime deri edhe protesta të grupeve të interesit, të cilët kanë kundërshtuar ndryshimin e rimbursimit të TVSH-së nga skenari 20-20 në 20-6. Me lejon të them se ne i kemi dhënë të gjitha argumentet gjatë gjithë kohës në raport me grupet e interesit dhe kemi shtuar, përtej parashikimit, edhe një skemë rimbursimi, e cila, në fakt, i shkon fermerit në mënyrë të drejtpërdrejt. Përse e bëmë këtë?

E para, sepse mendojmë se ndryshimi i një pakete fiskle, që ka në thelb uljen e evazionit dhe ishte e duhur, e saktë, dhe duhej të shkonte në ndihmë të fermerit dhe jo vetëm të agropërpunuesve, sidomos nëse flasim për një efekt, i cili në raport me të ardhurat që vinin nga rimbursimi i tvsh-së për vitin 2018, i llogaritur në administratën tatimore, ishte 280 milionë lekë.

Meqenëse gjatë fillimit të këtij viti u vumë përpara situatës që me këtë skemë të re nuk do të realizonim dot mbështetjen, vendosëm që këtë shumë t’ia jepnim fermerit në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të rimbursojmë fermerin.

Përtej faktit se çfarë kërkesë erdhi nga Ministria e Bujqësisë, kjo tregoi edhe një shkallë të lartë informalitetit, sepse kërkesa erdhi për më shumë se ajo që regjistronim ne të Ministria e Financave dhe ky ishte momenti i parë i një ballafaqimi të një realiteti, ku ndryshimi i skemës, në fakt, po thyente një tabu që ishte informaliteti.

Të tushash gjithmonë se skema është gabim, është një element, por që skema të eliminojë informalitetin, kjo ishte shumë e qartë në raport me të dhënat që ne morëm dhe analizuam.

Nuk duhet ta shkojmë gjithmonë skemën si problem, por paralelisht me të edhe informalitetin. Që të eliminojmë këtë duhet që të dyja palët të kontribojnë në përmirësimin e

përfitimit të fermeri dhe të mos harrojmë se në të njëjtin vit që u vendos ajo skemë, 1,2 miliardë lekë i mungojnë buxhetit të shtetit këtë vit, nga i pritshmi, për një lehtësi tjetër që edhe paralelisht me atë skemë, ku tvsh-ja e imputeve dhe e makinave bujqësore për një benefit të menjëhershëm të fermeri shkoi në zero.

Pra, janë të rëndësishme që këto t'i shikojmë bashkë.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre,

Para se ta kalojmë fjalën te zëvendësministri, për ta kuptuar unë drejtë, ju iu referuat skemës si korrekte, apo jo? Për qumështin? Po.

E dyta, këtë pyetje e kam për ju, zonja Ministre, por përgjigjen le të ma japë Nikoja. Sa keni rimbursuar për fermerët në vitin 2019?

Anila Denaj – Është shumë e vogël shuma, më pak se 100 milionë.

Arben Ahmetaj – Sa keni rimbursuar në vitin 2018?

Anila Denaj – Ka një këndvështrim edhe likuiditeti në një farë mënyre, sepse për arsye të fondeve, të cilat, për një skemë që u vendos në fillim të këtij viti, u rialokuan në aktin normativ, të cilat u shtuan me 200 milionë lekë.

Arben Ahmetaj – Pyetja ime është për rimbursimet të fermerët.

Nikolla Lera – Nuk i kemi tabelat analitike me vete.

Arben Ahmetaj – Viti 2019 ka qenë 1,8 deri në 2,2 miliardë.

Ti e di mirë që unë e di dhe i kam shifrat. Pra, ajo që thotë ministrja duhet netuar. 1,2 miliardë nga importi me 1,8 miliardë nga rimbursimit neto, plus 600 milionë. Pra, neto plus efekt në tvsh-në bruto është 600 milionë, Niko. Pra, në qoftë se ti ke dhënë 1,2 nëpërmjet importit të gjithë gamës...

(Diskutime pa mikrofon)

Makineritë kanë qenë, Niko. Kanë qenë mbi 500 milionë pastaj ia lejuam edhe zinxhirin e importit (pra 1,5 dhe në anën tjetër është 2,2 rimbursimi i vitit 2018, pra 700 milionë është neto plus tvsh-ja).

Kur i numërojmë efektet e përjashtimeve, do të numërojmë efektet e korrektimeve. Kështu që, na i sillni edhe këto shifra, se janë të rëndësishme.

Nikolla Lera – Patjetër, këto janë në nivel shumë analitik dhe mbase është gabimi ynë që nuk i morëm.

Arben Ahmetaj – Ne ju përballojmë edhe në analizë.

Nikolla Lera – Dua të sqaroj diçka lidhur me analizën tuaj dhe me pyetjen e deputetit. Ku flasim për grumbulluesit, kemi grumbulluesit e produkteve bujqësore, kemi edhe ato të produkteve blegtorale, që e çojnë te përpunuesit vendas.

Nga 2,2, janë 400 milionë që i përkasin kreditimit që kishin bërë përpunuesit për efekt të qumështit. Ne e ulën nga 20% në 6%. 400- milionëshi u përballua 120 milionë, 6%-shi, dhe 300 milionë Ministri i Financave çeli fonte për subvencionim në mënyrë që efekti tek qumështi të ishte zero, ndërkohë që pjesa tjetër, 2,3 minus 400, që është 1,8, duhet verifikuar si ka qenë...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Keni ndonjë pyetje tjetër?

Vullnet Sinaj – Meqë ju diskutuat për problemin që ngrita, nga kjo kuptova (dhe e dija ndërkohë), se rimbursimi është ulur për grumbulluesit e të fruta-perimeve dhe të qumështit.

Çfarë ka ndodhur në realitet (se ne kemi një Ministri Financash që përfshin edhe Ministrinë e Ekonomisë)?

Me sa di unë, ky ligj u bë për të ulur rimbursimin e madh që ishte për grumbulluesit e perimeve. Nga ana tjetër, ndodhi që në njëfarë mënyre u rregullua, se unë kam vajtur dhe i kam takuar vetë grumbulluesit e perimeve. Ata e kanë rregulluar në mënyrë të tillë, se ata nuk shesin në tregun vendas. Ata e marrin nga fermeri me 6% dhe e eksportojnë me 6%. Në këtë rast atyre u ishte dëmtuar çmimi për të konkurruar tregjet europiane dhe unë nuk e di se çfarë efekti ka dhënë në eksport. Po efektin më të madh kjo e ka dhënë te qumështi, tek ata që grumbullojnë qumështin.

Në momentin që ata e grumbullojnë qumështin nga fermerët e vegjël me 6% dhe pastaj janë të detyruar ta sheshin në tregun e brendshëm me 20%, kanë një kosto 14% më të lartë. Çfarë ndodh?

Ata kanë rritur importet në këtë rast, kanë gjetur qumësht në Ballkan dhe e importojnë me 20%, që të mos e kenë këtë kosto, duke u dalë, sipas llogarive që ata bëjnë, me 7 lekë. Pra, çfarë kemi bërë? Kemi bërë që grumbulluesit e brendshëm të qumështit, ose nuk u japin fatura të rregullta TVSH-je furnizuesve të tyre, për të mos e paguar këtë 14% dhe rrisin informalitetit, ose, nga ana tjetër, kemi goditur blegtorët vendas dhe kemi rritur importet.

Unë dua që kjo të korrigjohet. Kjo që them është e vërtetë.

Arben Ahmetaj – Nuk rezulton kjo që thatë. Të na thotë ministria shifrat, se ata janë të zotët e shifrave.

Vullnet Sinaj – Unë do t'i propozoja Ministres ta bëjë TVSH-në e barabartë në grumbullim dhe në shitje.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

Anila Denaj – Unë po sqaroj vetëm një element që thatë për të eliminuar impaktin te buxheti i shtetit. Në fakt, ajo që po thosha pak më parë, është se skema e rimbursimit që vendosëm këtë vit ishte pikërisht për të eliminuar këtë efekt që perceptohej si një element i krijuar nga buxheti i shtetit. Në fakt, nevoja për të shkuar përfitimi direkt te fermeri ka qenë obligimi i parë, si me skemën e imputeve, ashtu dhe me skemën e rimbursimeve. Gjithë ky proces, që nga autofaturimi, sikurse edhe rimbursimi, gjatë x vjetëve, nuk ka sjellë atë pritshmëri në formalizim, ky nuk është problemi i një taksimi dhe duhet të shkojnë të gërshetuara. Sot nuk zgjidhen dot vetëm me një politikë fiskale gjithë problematikat që lidhen me informalitetit.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, kemi nevojë për dy shifra, sepse te çdo skemë taksimi ose subvencionimi direkt ose indirekt reflektohet në rritjen e sektorit.

1. A është rritur këtë vit bujqësia si sektor?
2. Eksporti i produkteve bujqësore ka rënë apo është rritur?

Kjo për t'iu përgjigjur direkt dhe indirekt shqetësimit që ka deputeti, nëse të dyja këto përgjigje janë pozitive, pra nëse rritja e sektorit, automatikisht edhe e çdo individ apo entiteti brenda sektorit, në bazë të konkurrueshmërisë, do të jetë e faktuar edhe statistikisht. Ulja e rimbursimit që ishte një subvencionim direkt i madh, me goditje 2,5 miliardë në buxhetin e shtetit, që s'është asgjëkund si skemë, mund ta rishikoni, nuk diskutohet. Unë e ftoj deputetin, në respekt të asaj që tha, ta bëjë si amendament nëse do, për ndryshimin e skemës. Jam i bindur që brenda qeverisë ka anëtarë qeverie që janë shumë të interesuar për ta zgjeruar skemën e bujqësisë, mund të gjeni mbështetje, dhe ne do ta votojmë me kënaqësi, që të shkojë sërish siç ka qenë.

Faleminderit!

Elton Haxhi – Në lidhje me pyetjen që sapo u shtrua, bujqësia është rritur në rangun 1,8-1,9%, ndërsa prodhimi bujqësor, eksportet, janë rritur me plus 14%.

Arben Ahmetaj – Kjo është e rëndësishme dhe është një përgjigje shumë interesante për të gjithë ata që me qëllim apo padije dyshuan te politika shumë e saktë e Kryeministrit Rama për të përjashtuar imputet dhe për të ulur rimbursimin. Shumë njerëz të qëllimtë ia kundërshtuan

këtë politikë (edhe nga padija patjetër), duke i thënë se do të shkatërrohet bujqësia. Fakti sot është që bujqësia është rritur gati 2% dhe fakti është që, megjithëse eksportet totale kanë rënë rreth 3%, eksportet bujqësore kanë kapur rekord në 14%. Kjo është përgjigje për të gjithë të qëllimtët dhe ata që nuk e dinë se ka metër statistikor dhe ekonomik për zhvillimin e çdo sektori.

Ndërkohë që shpresoj se shqetësimi i zotit Vullnet është fundamental, është korrekt...

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet, nuk e kisha fare me çfarë propozove ti. Ka një diskutim që e bëjmë së bashku, që quhet “analizim i politikave”. Pra, a kanë qenë të sakta apo jo? Kjo është shumë e rëndësishme, sepse ky ka qenë një debat shumë i madh kur Kryeministri e hodhi si politikë, pra balancimin midis rimbursimit dhe përjashtimit të imputeve. Shumë njerëz nga sektori iu turrën dhe i thanë që do të bjerë bujqësia, do të na shkatërrohet bujqësia, do të na bjerë eksporti, por fakti ka verifikuar të kundërtën, ka treguar se politika e Kryeministrit ka qenë super e saktë.

Faleminderit!

Elton Haxhi – Doja të shtoja edhe diçka tjetër, që subvencionimi apo ndihma për grupe të caktuara nëpërmjet politikave fiskale është i gabuar. Nëse duhet dhënë subvencionim për një grup të caktuar, parashikohet, kostohet, matet. Nëse bëhet nëpërmjet politikës fiskale, në gjykimin tonë, nuk është politikë e drejtë dhe nuk duhet të vazhdojë më të subvencionohen nëpërmjet politikës fiskale. Mund të jepet subvencion direkt, i cili është edhe i matshëm dhe në efekte edhe në kosto.

Në lidhje me pyetjet e tjera që ju shtruat, renta minerare në eksport, i pritshmi, është 2,4 miliardë të ardhura. Parashikimi për vitin tjetër është 2,6 miliardë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Plani ka qenë 2,8, kurse i pritshmi është 2,4 dhe për vitin tjetër është 2,6. Eksportet e mallrave janë 1,1 %, eksportet e shërbimeve janë 2%, të dyja bashkë janë 3,1. Tek eksportet e shërbimeve kontributin e ka kryesisht turizmi. Kjo i përgjigjet pyetjes suaj në lidhje me turizmin.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje tjetër?

Vullnet Sinaj – Unë kam shkuar dhe kam takuar fermerët, por kam marrë edhe të dhëna nga dogana. Unë kam marrë vetëm një produkt, eksportin e domates. Kontrollojeni se për këtë 9-mujor e keni më të ulët se vitin e kaluar.

Arben Ahmetaj – Të bëri sfidë deputeti. Përgjigjuni tani, zoti Zëvendësministër!

Ti ke marrë vetëm eksportin e domates, apo në tërësi?

Mbylle mikrofonin, Vullnet!

Zoti Zëvendësministër, në të drejtë të tij, deputeti ju bëri sfidë. Ai pyeti a është rritur vetëm eksporti i domateve apo i të gjitha produkteve bujqësore?

A mund të na përgjigjeni zyrtarisht, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ervin, unë e di që ju vini nga Berlioni, por ne kemi ditë që punojmë dhe buxheti është i rëndësishëm.

Po.

Elton Haxhi – Jo, nuk është vetëm domatja, por e gjithë shporta e produkteve bujqësore.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Të sfidoi, prandaj ta thashë.

A ka pyetje tjetër?

Po, ju lutem!

Krenar Ryçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, që jeni këtu! Edhe pse shifrat që ju paraqitët sot pranë komisionit ishin të pritshme, por unë doja të dija, me të gjitha këto realizime dhe të gjitha këto shifra që ju na dhatë (mendoj se pjesa e pagave nuk u prek fare nga ana juaj), a keni ndërmend të bëni rritje pagash për vitin në vazhdim si për pensionistët, ashtu dhe për familjet në nevojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Ju pyesni për pagat, por ne sot jemi tek të ardhurat, kur të vijmë të shpenzimet mund ta ngrini pyetjen tuaj, sepse kemi disa sesione mbledhjesh.

Krenar Ryçi – Kisha një pyetje tjetër. Çfarë kuptoni ju me rritje ekonomike? Këtë pyetje e kam për drejtorin. Ne kemi një ekonomi të brishtë dhe jetojmë vetëm me taksa. Për çfarë ekonomie e kishit fjalën?

Arben Ahmetaj - Ti je drejtor, je punonjës administrate, je TND. Rritja ekonomike ka dy referenca. Po ta them thjesht. E para, është nga sektorët dhe e dyta është ofertë-kërkesa. Po t'i shohësh të dyja në aspektin e konsumit, të investimeve, e njëjta gjë vlen edhe për sektorët, përveç ndërtimit që ka një ngadalësim të lehtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e quani rënie pikiatë, unë e quaj rënie të lehtë. Shifrat janë shifra.

Pra, rritja ekonomike vjen nga sektorët e bujqësisë, shërbimet, ndërtimi etj, nuk është se ti jeton me taksa, sepse ti je tatimpagues, jeton nga taksat e shqiptarëve bashkë me mua, sepse paguhemi këtu, por unë iu referova të ardhurave bruto për frymë dhe që është një tregues shumë i rëndësishëm, pastaj nëse do të bësh një për rishpërndarjen e kapitalit që të kalosh majtas me ne, je i ftuar, por jo sot, sepse sot kemi diskutimin për të ardhurat. Vullneti është i majtë si unë, ne jemi ekstrem të majtë, kurse këta janë të majtë të qendrës.

A ka ndonjë pyetje tjetër për të ardhurat?

Vullnet Sinaj – Kam një pyetje të fundit.

Te raporti për të ardhurat e vitit 2019, TVSH-ja, thoni ju, për këtë moment është -6,8 miliardë, kurse tatimi mbi fitimin është +2,5 miliardë, pra -24, +10%. Si e shpjegoni që ka rënie të të ardhurave nga TVSH-ja dhe rritje ta ardhurash nga tatimfitimi?

Faleminderit!

Niko Lera – Ashtu sikurse e shpjeguam, por edhe ministrja i përmendi ne faktorë, në tatimin mbi vlerën e shtuar kanë dhënë impakt faktorët direkt ,që kanë të bëjnë me të, sikurse janë kursi i këmbimit, i cili ndikon direkt bazën e llogaritjes së tatimeve për çdo mall importi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse tatim-fitimi është i tejkaluar? Sepse ju e dini që tatimfitimi deklarohet në 31 mars të vitit pasardhës për vitin paraardhës. Në vitin 2019 ne patëm fluksin pozitiv të sektorit energjetik të vitit 2018 dhe patëm pagesa në nivele të larta të KESH-it, të OSHEE-së dhe të operatorëve të tjerë, përfshirë dhe ata privatë. Pjesa tjetër vjen nga reflektimi i rritjes ekonomike të viteve të kaluara, të vitit 2018, në deklaratat e tatimpaguesve, pra është logjike dhe normale. Pse nuk jemi në TVSH? Ne thamë që në tatimin mbi vlerën e shtuar në total kemi të argumentuara me faktorë të njehsuar dhe e llogaritën 11,6 – 4, pra diku te 7,6 miliardë dhe thamë që kemi të pidentifikuar 2 miliardë, që do t'i shohim se nga cilët faktorë kanë ardhur, nga administrimi i keq apo nga faktorë të tjerë.

Pse TVSH-ja e brendshme është më e ulët? E para, sepse për rreth 2,5 miliardë arkëtimi i TVSH-së nga energjia elektrike u zhvendos nga prodhimi i vendit në import, sepse u importua dhe u pagua në doganë. E dyta, sepse rimbursimet në vitin 2019, kanë qenë rreth 4,5 miliardë më të larta se në vitin 2018. E treta, sepse projekti TAP, i cili gjeneronte TVSH neto në

buxhet në vitet 2017-2018 mesatarisht 3 miliardë, në vitin 2019 gjeneroi vetëm 34 milionë. Pra, një pjesë e të ardhurave që arkëtoheshin brenda vendit, janë arkëtuar...

Arben Ahmetaj – Sa e rimbursuje TAP-in në 2018-ën?

Niko Lera – Në vitin 2018 është rimbursuar në shifra shumë të ulëta.

Arben Ahmetaj – 300 milionë çdo muaj.

Niko Lera – Jo që në fillim.

Arben Ahmetaj – Më jep shifrën!

Niko – Nuk ka marrë më shumë se 2 miliardë tërë vitin, kurse sivjet ka marrë 350 milionë çdo muaj.

Arben Ahmetaj – Efekti i TAP-it është 1 miliardë?

Niko Lera – Është më shumë.

Arben Ahmetaj – Mirë, më jep shifrat!

Niko Lera – Është diku te 2 miliardë.

Arben Ahmetaj – Të mos e mbivlerësojmë TAP-in! Dua që të kapim thelbin!

Niko Lera – Them që është si faktor.

Arben Ahmetaj – Si faktor kuantifikohet, dhe kur e ngre kuantifikimin këtu do të kalosh në shifra dhe detaje, që t'i referohesh efektit neto dhe efekti neto nuk është 3 miliardë, se në anën tjetër e kemi rimbursuar. Megjithatë nuk ka rëndësi, na sill vetëm shifrat, dua të gjitha të dhënat që kërkoj!

A ka pyetje tjetër?

Po, Senida.

Senida Mesi– Meqë dolëm te kjo logjikë do të doja të përmendja edhe një element shumë të rëndësishëm. Flasim për situatën ku jemi dhe ku e filluam vitin e kaluar, por nuk përmendet në asnjë moment paketa fiskale e vitit të kaluar në kuadër vetëm të një zëri, TVSH-së. Ne pranuan ta ulnim pragun e TVSH-së për subjektet 2 milionë e lart, ndërkohë që nuk e dëgjoj askund se cili ishte ky efekt, sepse presupozohet që unë kam marrë më shumë TVSH nga subjektet pa pjesën e rimbursimeve. Besoj se edhe kryetari duhet të dakordësojë që ne të kemi gjithmonë dy zëra, që të kuptojmë sa ishte TVSH-ja që kemi akumuluar, sa ishte ajo e rimbursueshmja, për të kuptuar që, nëse ka zbritje, është realisht diferenca neto pikërisht me TVSH-në e arkëtuar me atë që ne disbursojmë. Besoj se këtu kemi dakordësi.

Arben Ahmetaj – Pyetjen e bëra unë më përpara, jemi në të njëjtën linjë, se edhe më parë jo pa qëllim e diskutova TVSH-në bruto për të konsoliduar më tepër të pritshmin dhe rritjen për vitin tjetër, se është e rëndësishme që të jemi në baza reale, megjithatë ministria do t'i sjellë shifrat, por të njëjtën pyetje e bëra edhe unë pak më parë.

Senida Mesi – Ndërkohë po në të njëjtën linjë ne kemi aprovuar vjet një sërë paketash dhe është shumë e rëndësishme për ne, si anëtarë të komisionit të kuptojmë cilat ishin efektet pozitive, cilat mund të kishin qenë edhe ato negative, për të ditur nëse do të vazhdojmë përsëri vitin që vjen me të njëjtën metodologji pune, apo të dyja palët kemi incentivën e mjaftueshme, si nga ana e qeverisë, ashtu dhe nga ana e parlamentit, që të vazhdojmë më të njëjtën tipologji reformash, apo paketash fiskale, gjithmonë në dobi të ekonomisë, të vjeljes së të ardhurave, por edhe në dobi të bizneseve. Pra na ndihmon edhe ne një analizë e tillë për të ndërmarrë nisma ligjore, duke filluar nga biznesi, me qëllim që shkojmë të dyja palët në të njëjtin drejtim.

Anila Denaj – A mundem?

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Anila Denaj – Zonja Mesi, unë e përmenda edhe kur zoti Bushati kërkoi një analizë *cost-benefit* dhe ju thashë që bashkë me FMN-në jemi duke përgatitur këtë gjë. Sot e kemi një draft, mund t'ju sjellim gati, por menduam që brenda ministrisë bashkë me një grup deputetësh, kryesisht të Komisionit të Ekonomisë, të bëjmë një diskutim më të qenësishëm për paketën fiskale në 3-4 vitet e ardhshme, në mënyrë që të kemi mundësi ta konsultojmë me grupet e interesit, duke filluar nga viti tjetër, sigurisht një draft që mund ta ndajmë. Do të ishim shumë të lumtur sikur edhe ju të merrnit pjesë në diskutimet tona të brendshme, edhe për pragun, i cili është një nga elementet e kontestueshme, sidomos nga FMN-ja.

Niko Lera – Ne ulëm pragun nga 5 milionë...

Arben Ahmetaj – Niko, në ministri i merret leje ministres.

Niko Lera – Më fal!

Arben Ahmetaj – A ka pyetje tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëri ministrja. Më vjen keq, por ajo iu përgjigj korrekt.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Zëvendësministër, a mund t'i përgjigjeni pyetjes?

Faleminderit!

Elton Haxhi – Unë do të doja të ftoja Komisionin Parlamentar të Ekonomisë të bëhet pjesë e grupit tonë të punës për hartimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave, kështu që jeni të mirëpritur të caktoni përfaqësuesin ose sekretariatit, ose ndonjë anëtar të komisionit, në mënyrë që të ketë një përfshirje apo dakordësi që në fillesat e hartimit të strategjisë.

Arben Ahmetaj – Jeni shumë i saktë dhe ju falënderoj, do të bëhemi, por pse nuk u bëtë ju që në shtator me buxhetin, që të mos i kishim këto diskutime, dhe ta na kishit përfshirë, siç kemi bërë ndër vite me PBA-në, që të mos bënim këto debate e këto pyetje, por të ishim shumë më të qartë?! Apo duke na dëgjuar ne ju erdhi në mendje të na ftoni? Do të vijmë patjetër, që të bëjmë strategjinë afatgjatë.

Tani, unë po e bëj pyetjen më tepër si ndarje meraku edhe në logjikën e pyetjeve, pra për të mos i përsëritur pyetjet, Ministre, sepse ju dhe punonjësit tuaj iu përgjigjët të gjithave.

E para, meraku im kryesor ngelet TVSH-ja për shkak se ky vit ka pasur një profil TVSH-je shumë të vështirë, ku TVSH-ja bruto e këtij viti është gati njësoj me një vit më parë.

Zoti Niko, po ju drejtohem edhe juve.

Kur ta kalojmë planifikimin nen për nen të jemi pak më konkret në shifra dhe nga do të vijë TVSH-ja.

E dyta, ajo që tha Niko për tatimfitimin, unë do të doja të shihja profitibilitetin, pra fitueshmërinë vit pas viti dhe ta zhvishni nga sektori energjetik, që është shumë e rëndësishme, dhe të kapni pjesën tjetër, pra jashtë 3 kompanive të energjisë, për të gjykuar si e kemi bazën e fitueshmërisë të ndërmarrjeve private kryesisht. Ne e kemi bërë këtë ushtrim në vazhdimësi dhe është mirë ta bëjmë edhe me komisionin, që edhe ai të kuptojë bashkë me ju se ku jemi me fitueshmërinë dhe pse kemi planifikuar atë fitim.

Në të njëjtën kohë, po të shohësh tatim-fitimin është 2,1% e PBB-së, pra 2,1 në vitin 2018 dhe 2,1 në vitin 2019 dhe 2,1 në vitin 2020 në raport me PBB-në. Besoj se ia vlen ta analizojmë nen për nen, që të jemi të qartë dhe të qetë se ku jemi duke shkuar me këtë.

Meraku tjetër. Po ta shohësh, të ardhurat tatimore në 2018-n ishin 25,7% e PBB-së, të ardhurat nga tatimi dhe doganat në 2018-n ishin 18,7% e PBB-së, në 2019-n është 18,4%, pra me një rënie në raport me PBB-në me 0,3. Rikuperim në 2020-n nën 2018-ën, prandaj besoj se kemi shumë vend për të diskutuar dhe për të përmirësuar, sepse 2020-ta do të duhet të kapë të paktën nivelin 18,7. Gjithsesi ky është një diskutim që do ta bëjmë nen për nen.

Meraku tjetër është tek TVSH-ja. Unë e thashë që keni planifikuar 0,3% rritje në raport me PBB-në. Unë do ta theksoj prapë merakun tim, në mënyrë që të kemi mundësi t'i shohim elementet një nga një. Ajo për të cilën nuk bie dakord me ju është planifikimi për të ardhurat nga taksa e pronës. Diskutimin për taksat do ta bëjmë nen për nen. Te taksa e pronës ju keni planifikuar më pak, pra shifra në 2019-ën është më pak se në 2018-ën, por nuk kemi arsye t'i hyjmë kësaj, se po bëjmë një reformë serioze tek taksa e pronës. Detyra e bashkive është të mos devijojnë nga metodologjia dhe nga detyra për të pasuruar platformën. Domethënë në këndvështrimin tim, por edhe nga eksperiencia ime më taksën e pronës, nuk ka më asnjë justifikim që bashkitë të devijojnë nga logjika e metodologjisë dhe nga popullimi i *database-it*, se është shumë e rëndësishme.

Pavarësisht se për ju, si Ministri e Financave, në lidhje me deficitin apo me primin, nuk do të kishte të njëjtën vlerë, por në aspektin e shëndetit të pushtetit vendor, se Antoneta bën gjithmonë pyetje për pushtetin vendor, këtë gjë nuk prekët dhe dua që ta prekni në vijimësi.

Të njëjtën gjë kam me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ku ritmi i rritjes lëviz jashtëzakonisht shumë, për shembull, tatimfitimi është nga 2018-ta në 2019-ën 2,1%, pastaj shkon 8%, pastaj TVSH-ja është minus 2,3% nga vitet 2018-2019, pastaj rritet me 8,2%. Pra, janë shqetësime që dua t'i diskutoj me ju nen për nen, prandaj i shtroj tani që të arrijmë një nivel të konsoliduar për të pritshmit e këtij viti dhe të asaj që planifikojmë për vitin tjetër.

Te jotatimorët, unë besoj se keni edhe frekuenca të telekomunikacionin për të shitur. A i keni planifikuar apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më duket se në detajim nuk i keni planifikuar. Nëse i keni mbajtur rezervë, zëre se nuk e thamë, dhe do t'u themi kamerave që nuk e thamë. Por, nëse nuk i keni mbajtur si rezervë, atëherë duhet t'i rishikojmë edhe një herë.

Po u referohem të ardhurave personale, ku besoj se minus 1% keni llogaritur zbritjen e dividendit dhe emetimin me 4 miliardë. Apo nuk është kështu? E kam zyrtare, prandaj e dua me zë. Pra, është llogaritur minus dividend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, emetimi është minus 2 miliardë. Dakord. Sekretaria duhet ta mbajë shënim, sepse do t'i shikojmë një e nga një, kur të vijmë nen për nen.

Dakord, unë nuk kam asgjë tjetër vetëm mbështetje dhe shpresë që të ardhurat e vitit 2019 të jenë aq sa ju keni deklaruar si të pritshme, sepse përtej çdo merakut, dy muajt e fundit mund të jenë të vështirë, pastaj baza e përlllogaritjes për vitin tjetër i bie të ulet, dhe viti vështirësohet edhe më shumë. Këtë nuk e meritojmë as ne dhe as ju.

Po, zonja ministre mund ta mbyllësh.

Anila Denaj – Faleminderit për pyetjet!

Në diskutimet që do të bëjmë nen për nen ne do të argumentojmë të gjitha elementet që kemi sjellë. Zoti kryetar, ne kemi dy elemente në vëmendje që kanë të bëjnë me taksën e pronës, që i përmenda edhe në pyetjen e zonjës Dhima. Një ndër arsytet përse nuk jemi treguar optimist është, sepse janë 33 bashki që nuk kanë marrë vendime në këshillat e tyre bashkiak. Ky nuk është një proces i menaxhuar totalisht nga ne, prandaj duhet të jemi konservator.

Sigurisht që ka edhe elemente të tjera për t'u parë, siç janë kontributet, të cilat në gjykimin tonë janë realiste. Elementi i vetëm që jemi të gatshëm të shikojmë zë më zë është TVSH-ja. Edhe këtë vit ky është zëri që ka ndikuar më shumë, prandaj jemi të gatshëm ta diskutojmë në të gjitha parametrat kur të flasim nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, por pritshmëria e këtij viti, sikurse e thatë edhe ju, është baza dhe elementi kyç për të vendosur, sidomos në këtë fund muaji, të gjitha perspektivat e TVSH-së për vitin tjetër.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti